 - Ndërrimi I njektorëve në Bunarin I për rezervoarin Kala dhe Rezervoarin e Kurillës(për KFOR-in Gjerman). Pasi që I kemi dërguar të dy injektorët për riparim, edhe pse nuk jemi dakorduar për çmimin e riparimit(në zyrën e Kryeshefit Ekzekutiv), jemi dakorduar të furnizohemi me injector të rinj(çmimi shumë më I favorshem se riparimi I injektorëve të vjetër), kemi bërë montimin e tyre për këto rrjeta të furnizimit;

- Furnizimi I rregullt me Na-Hipoklorit fshatrat e Hasit,L.e Hasit, K.i Hasit dhe Kushnin;
- Ndërrimi I bombolës 1t-she me klor gaz në Mulli;
- Shënim: Edhe pse kemi pasur shume vështësi për furnizim të rregullt të konsumatorëve me ujë të klorinuar(për shkak të problemeve të lartëcekura) kemi arrijtur që asnjë analizë e ujit të mos devijojë për nga kualitetit gjegjësisht, të gjitha analizat I përgjigjen standardeve të ujit të pijes.
- Eliminimi I defektit në injektorin në „Mulliri i Vjetër” në Φ 400;
- Pranimi I ngarkesës së klorit dhe ndërrimi I bombolës 1t-she me klor gaz në Mulli.
- Është eliminuar defekti në injektorin për klor gaz te Pusi I Atit;
- Mbledhje me anëtarët e Bordit për Hulumtime dhe Teknologji. Është dhënë raporti për cilësi të ujit ;
- Për shkak të ankesës për kualitet të ujit në fshatin Kabash të Hasit janë marrë hapa të duhura për eliminimin e parametrave që kanë ndikuar në cilësinë e ujit në këtë fshat. Kështuqë, është bërë dezinfikimi i rrjetit dhe rezervoarit në tërësi(3 ditë). Janë bërë analizat e duhura, bakteriologjike dhe fiziko-kimike, disa herë, përderisa analizat nuk kanë qenë në nivelin e duhur, gjegjësisht, kur analizat kanë qenë negative. Vlen të përmendet se, përderisa nuk eliminohen shkaktarët që mund të ndikojnë në cilësinë e ujit nuk do të ketë rezultate të kënaqshme(largimi I plahërave përgjatë rrjetit furnizues si dhe përcjellja e dozimit të klorit në mënyrë permanente (klori residual);
- Kemi vizituar Ujësjiellësin e Zhur-it për të instaluar dozatorin për dozimin e klorit me Q.Jonuzin, por aparati në fjalë nuk ka funksionuar;
- Pasi që dozatori për dozimin e klorit në Lubizhdë të Hasit është jashtë funksionit kemi insistuar që punëtori I ngarkuar për këtë çështje të dozojë klorin me pika përderisa dozatori të riparohet nga ana e Q.Jonuzit.
- Eliminimi I defektit në injector për klorifikim në Bunarlluk I;
- Vizita në Prishtin për furnizim me reagjent dhe paisje në “eraMED”;
- Ndërrimi I bombolës 1 t në objektin e Mullirit;
- Vizita në ujësjiellësin Hoqa e Qytetit për inçizimin e gjendjes aktuale së bashku me ekipin e mirëmbajtjes (është dhënë raporti për këtë vizitë), 2x;
- Vizita në objektin e ujësjiellësit Zhur ku është bërë riaktivizimi I procesit të klorifikimit (është vënë dozatori për dozimin e klorit) 2x;
- Furnizimi I rregullt të fshatrave me ujë zhaveli për fshatrat e Hasit: Lubizhdë,Kushnin,Kabash, si dhe Zhur;
- Riparimi dhe vënja e bravës dhe të zinxhirit në derën e rezervoarit Kala;
- Përcjellja permanente e klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit;
- Furnizimi I rregullt me Klor të lëngët të fshatrave të Hasit, Lubizhda , Kabash dhe Kushnin;
- Vizita në Prishtinë në ZRRUK te z.Qamil Musa. Diskutuam rreth çështjes së Monitorimit të Mbrendshëm. JU kemi njoftuar më hollësisht në lidhje me këtë çështje;
- Pas ankesës së disa konsumatorëve në Lagjen Bajram Curri dhe Arbanë kemi vizituar konsumatorët në fjalë dhe konstatuam se sa I përket kualitetit të ujit çdo gjë ishte në rregull. Prezent ishte edhe Menaxheri Teknik L.Paqarizi;
- Pas erërave të forta kemi pasur ndërprerje të energjisë elektrike në 40 Burimet si dhe te pompat në ashtuq.”Te Livadhi”.Pasi që furnizimi disi u stabilizua është dashur që të largojmë ujin për shkak të turbiditetit. Veprime të tilla I kemi përsëritur disa herë përderisa u stabilizua gjendja gjegjësisht, deri sa nuk ka figuruar turbiditeti;
- Shkarkimi I ujërave në 40 Burime me gravitacion për shkak të rreshjeve të mëdha si dhe mungesës së energjisë elektrike(nuk kemi mundur të aktivizojmë pompat). Të nesërmen në mëngjez, pasi që sistemet u stabilizuan, menjëherë, I kemi futur në sistem duke e përcjellur vazhdimisht gjendjen në teren;
- Me kërkesë të ekipit të kontrollit kemi bërë kontrollin e ujit në fabrikën “Dratex”-Dragash.
- Dalja me ekipin e kontrollës për verifikimin e keqpqrdorimeve eventuale në lagjen Dardani, pjesa e fundit nga ndëramprrja “Bini”;
- Pranimi i ngarkesës së klorit, klor gaz 1 t dhe montimi i saj dhe 5 x 150 kg bombola me Cl- gaz;
- Furnizimi I rregullt të fshatrave të anës Hasit, Kabash, Lubizhdë dhe Kushnin si dhe ujësjiellësin Zhur;

- Me kërkesë të ekipit të kontrollës kemi kontrolluar ujin e pijes në Arbanë, pasi që ka pasur ankesa për kulitet të ujit, I vie era ujit. Është konstatuar se ka përzjerje të ujit të pijes me atë të vadës;
- Ndërrimi I të gjitha bombolave kundër zjarrit në vëndet ku janë rojtarët;
- Eliminimi I defekteve në kabllo të elektrike në laborator(ndarja e rrjetave sipas fuqisë së aparateve dhe instrumenteve në laborator). Për shkak të ngarkesës siguresat nuk kanë funksionuar në mënyrë të rregullt;
- Disa ditë nuk ka pasur ujë në rrjetë;
- Riparimi I pompës për dozim të klorit në Mulli, në O 400.

Analizat Bakteriologjike Janar - Dhjetor 2015, ISHP-Prizren

| Njësia | Nr.i mostrave | Përgjigjen | Nuk përgjigjen |
|-----------|---------------|------------|----------------|
| Prizren | 661 | 653 | 8 (1.21%) |
| Suharekë | 94 | 91 | 3 (3.19%) |
| Dragash | 29 | 29 | 0 |
| Malishevë | 53 | 50 | 3 (5.66%) |
| Totali | 837 | 823 | 14 (1.67%) |

Analizat Bakteriologjike Janar - Dhjetor 2015, Laboratori "Hidroregjioni Jugor" Prizren

| Njësia | Nr.i mostrave | Përgjigjen | Nuk përgjigjen |
|-----------|---------------|------------|----------------|
| Prizren | 239 | 236 | 3 (1.25%) |
| Suharekë | 28 | 28 | 0 |
| Dragash | 31 | 27 | 4 (12.90%) |
| Malishevë | 26 | 25 | 1 (3.84%) |
| Totali | 324 | 316 | 8 (2.46 %) |

Raport per trajtimin e Ujerave te Zeza, Janar – Dhjetor /2015

Raport për trajtimin e Ujërave të Zeza TMI

*Ecuria e projektit te ujerave te zeza gjegjesisht Impiantit per Trajtimin e Ujerave te Zeza ne Prizren per vitin 2014 eshte pershkruar ne raportet mujore dhe raportet periodike te cilat perpilohen nga Zyra e Konsulences dhe nga komiteti i projektit-KRU"HRJ"sh.a, dhe te cilat jane ne dispozicion tek Komiteti i Projektit,ne Arhive dhe gjenden ne forme te shtypur dhe elektronike.

*Tani po pershkruajm ne pika te shkurtera gjendjen aktuale te ketije projekti ne aspektin e progresit edhe per Fazen I edhe per Fazen II.

*Ky projekt eshte bashkfinancim ne mes te Republikes se Gjermanise dhe Republikes se Kosoves, kurse Komuna e Prizrenit ka bere kompenzimin e pronareve per shpronosimin e lokacionit ku do te ndertohet impianti dhe ate me siperfaqe prej afersisht 12ha ne fshatin Vlashne.

Projekti ndahet ne 2 Faza:

Faza I- Ndertimi i kolektorit kryesor ne anen e djathte te rrjedhjes se lumbardhit si dhe rehabilitimin e disa pikave problematike ne aspektin e funksionalitetit si ne laxhen Kurilla dhe ne Zonen Industriale.

Faza II- Ndertimi i Impiantit per Trajtimin e Ujerave te Zeza -ITUZ

*Sa i perket projektit per Grumbullimin dhe trajtimin e ujerave te zeza per qytetin e Prizrenit, pothuajse jemi ne fazen fillestare te ekzekutimit te projektit per te dy Fazat.

*Sa i perket Fazes se Pare eshte shpallur kompania fituese, PASSAVANT nga Gjermania &KWE nga Kosova si nenkontraktor e cila do te ekzekutoj punet ne teren me rreth 25% te kontates. Per kete projekt eshte nenshkruar Kontrata per punekryerje ne mes te kompanise fituese dhe KRU"HRJ"sh.a,

ne kontrate jane percaktuar te gjitha pozicionet e paramases per punet qe do te kryhen dhe eshte dhene plani dinamik i punimeve, si dhe ne baze te kontrates eshte parapare qe kompanise pune kryese ti paguhet 20% te vleres se kontrates si avans. Deri me tani eshte bere pagesa e 4% te ketije avansi me vlere prej 99,763.70 euro minus TVSH prej 16%, kurse vlere e mbetur e avansit duhet te paguhet sa me shpejte qe eshte e mundur, si kusht per fillimin e punimeve.

*Ne baze te disa takimeve qe kemi patur me kompanine konsulente dhe kompanine pune kryese jemi ne diskutim te zgjidhes se problemit me TVSH-ne pasi qe sipas Marreveshjes se vecant ne mes te KfW, MMPH, HRJ dhe Komuna e Prizrenit, pagesa per kompanine pune kryese duhet te behet nga kontributi vendor te cilin do ta paguaj MMPH.

Deri me tani ne si Komitet i projektit kemi nxjerre te gjitha lejet dhe pelqimet e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e projektit. Per momentin jemi ne procedure te marrjes se lejeve-pelqimeve per ekzekutimin e punimeve nga niveli Komunal dhe ai Qendror.

*Nga Kuvendi Komunal kemi bere kerkesen ne Drejtorine e Planifikimit dhe Urbanizmit, ku dhe kemi marre nje konkluzion per pelqimet percjellese te cilat nevojiten per marrjen e lejes nga drejtoria e urbanizimit per fillimin e punimeve.

*Nga Ministria e linfrastruktures do te merret pelqimi per pjesen e rruges ku Ministria ka bere zgerimin e rruges dhe ka nderhyre ne vijen tone te kolektorit. Kjo distance eshte 1.2km dhe fillon nga Rrethi per fshatin Hoqe e Qytetit dhe perfundon tek kycja ne Jug te Autostrades.

*Duhet cekur se pjesa problematike e lagjes Kurilla dhe Zones industriale eshte ofertuar pra jane dhene cmimet nga Pune kryesi por ende nuk eshte bere dizajni detal per shkak se keto zona duhet te inspektohen me CCTV te cilat poashtu i ka persiper kompania pune kryese.

*Vlere e kontrates per fazen e pare eshte gjithsejt 2,043,273.00 Euro, ne kete vlere nuk eshte e perfshire TVSH-ja, qe do te nenkuptonte se kompania Paswante ka ofertuar me kete cmim dhe nese kryhen te gjitha punet e parapara ne paramase duhet te paguhet kjo vlere e sipershenuar.

*Kan filluar parapergaditjet e kompanise implementuese sipas planit dinamik te paraqitur ne kontrate dhe pas takimeve, me crast eshte paraqite bill bordi i cili do te beje pershkrimin e puneve qe do te kryhen ne lidhje me fazen I, qe nenkupton eshte pershkruar donatori, perfituesi i projektit, titulli i projektit dhe emri i kompanise pune kryese, ne gjuhen Angleze dhe gjuhen shqipe. Dimensionet e ketije bill bordi do te jene 1X1.5m dhe do te vendoset ne vendpunishte.

*Sipas planit dinamik punimet parashihen te fillojne nga mesi i muajit Shkurt dhe pritet te perfundojne 365 dite pas kesaje date, po ashtu ne planin dinamik eshte dhene edhe afati i sugirise se punimeve i cili eshte 1 vit, po ashtu jane parapare edhe 5 dite kontrolla gjenerale, ku do te jepet certifikata e perfundimit dhe garancionit te punimeve. Ekziston Plani dinamik i realizimit te punimeve.

*Projekti i financuar nga komuna e Prizrenit „Sheshi i Lidhjes“ ne te cilin jane vendosur kolektoret konform projektit te parapare nga konsulenca dhe HRJ, projekt ky i cili ka perfunduar dhe eshte financuar nga Komuna e Prizrenit.

Ende nuk kemi marr ndonje njoftim nga Komuna e Prizrenit per mbarvajtjen e punimeve, pasi qe Pranimi Teknik duhet te behet edhe nga ana e HRJ-, si dhe patjeter eshte parapare incizimi i kolektorit me kamere. Ne kete projekt ne nje distance prej 230 m eshte vendosur Gypi i Ujesjellesit PE O400mm dhe Gypi i ujesjellesit PE O125mm, si dhe jane vendosur pusetat perkatese (*Për me tepër raporton Lumni Sallahu Udheheqes për Planifikim dhe Zhvillim*).

*Sa i perket Fazes se Dyte te projektit te ujerave te Zeza qe ka te beje me Dizajnimin dhe Ndertimin e ITUZ-se, momentalisht eshte shpallur kompania e cila eshte ranguar ne liste si kompania me e mire dhe me miratimin e KfW-se eshte ardhur ne perfundim se negociatat per fillimin e kontrates do te behen me kompanine AQUALIA&Hidroterm,

Me date 15.01.2015 eshte mbajtur takimi i pare ne lidhje me negociimin e kontrates me kompanine e ranguar e para ne liste, me perfaqesuesit e kompanise AQUALIA nga Spanja dhe me perfaqesuesit e Hidroterm nga Suhareka.

*Takim eshte mbajtur ne dy seanca, në seancën e parë nga 10:00 deri 13:00 u diskutuan çështjet e përgjithshme dhe administrative si dhe eshte viztuar lokacioni ku do te ndertohet impianti, dhe në Seancen e dytë në 17:00 deri 18:30 eshte diskutuar dhe sqaruar pjesa teknike e fabrikes.

Per kete takim ekziston raporti i MOM-minutave te takimit.

(Edhe per kete Faze ekzistojne raportet periodike ne te cilat eshte pershkruar komplet ecuria e projektit. Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi).

*Sa i perket pjeses se dyte te fazes se dyte te projektit te ujerave te Zeza qe ka te beje me Masat Shoqeruese siq dhe kemi me raportuar me heret jane parakualifikuar 5 kompani. Nga agenti i tenderit na eshte percjell dokumentacioni i tenderit per ofertetn teknike dhe financiare ne e kemi shiquar dhe i kemi kthyer komentet tona ne lidhje me kushtet e tenderit , dhe jemi ne pritje te miratimit nga ana e Agent Tenderit dhe KfW-se, pasi ketije dokumenti do te ftohen kompanite qe konform ketije dokumentacioni te sjellin ofertetn tekinke dhe financiare dhe pastaj pas evaloimit te ofertave do te shpallet kompania fituese. *Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi).*

Raport për trajtimin e Ujërave të Zeza TM2

Sa i perket Fazes se Pare qe ka te beje me ndertimin e kolektorit kryesor ne anen e djathte te rrjedhjes se lumbardhit dhe rehabilitimin e disa pikave problematike ne lagjen kurilla dhe ne zonen industriale:Jane kompletuar te gjitha pelqimet dhe lejet te cilat nevojiten per fillimin e punimeve ne teren dhe shume shpejt pritet fillimi i punimeve per Fazen I.(Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi dhe e posedojme raportin periodok ne te cilin jane pershkruar te gjitha aktivitetet ne lidhje me kete projekt).*

Sa i perket fazes se dyte te projektit te ujerave te Zeza qe ka te beje me ndertimin e ITUZ-se, kemi marr konfirmimin nga KfW per Kompanine AQUALIA&Hidroterm me te cilen kemi negocuar kontraten dhe jemi ne pritje te sigurimeve te duhura konform Dokumentacionit te tenderit me crast dhe pritet te nenshkruhat kontrata me kete kompani.(Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi).*

*Sa i perket pjeses se dyte te fazes se dyte te projektit te ujerave te Zeza qe ka te beje me Masat Shoqeruese si dhe kemi me raportuar me heret jane parakualifikuar 5 kompani. Nga agenti i tenderit na eshte percjell dokumentacioni i tenderit per ofertetn teknike dhe financiare te cilen do ta sjellin kompanite parakualifikuese, ne e kemi shiquar dhe i kemi kthyer komentet tona ne lidhje me kushtet e tenderit , dhe jemi ne pritje te miratimit nga ana e Agent Tenderit dhe KfW-se, jane ftuar kompanite per pergaditjen e ofertave dhe afati i dorezimit te ofertave eshte deri me 21 Maj, pastaj do te filloje faza e evaluimit ku dhe do te percaktohet kompania fituese per kete projekt.. *Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi dhe e posedojme raportin periodok ne te cilin jane pershkruar te gjitha aktivitetet ne lidhje me kete projekt).*

Sa i perket Fazes se Pare qe ka te beje me ndertimin e kolektorit kryesor ne anen e djathte te rrjedhjes se lumbardhit dhe rehabilitimin e disa pikave problematike ne lagjen kurilla dhe ne zonen industriale:Jane kompletuar te gjitha pelqimet dhe lejet te cilat nevojiten per fillimin e punimeve ne teren dhe shume shpejt pritet fillimi i punimeve per Fazen I.(Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi dhe e posedojme raportin periodok ne te cilin jane pershkruar te gjitha aktivitetet ne lidhje me kete projekt).*

*Sa i perket fazes se dyte te projektit te ujerave te Zeza qe ka te beje me ndertimin e ITUZ-se, kemi marr konfirmimin nga KfW per Kompanine AQUALIA&Hidroterm me te cilen kemi negocuar kontraten Kontrata eshte nenshkruar me 05.05.2015 Pas sigurimit te tenderit pritet te fillohet me Dizjanin e projektit dhe parapoergaditjet per fillimin e punimeve.

PasTakimeve qe kemi pas me Kompanine dhe korespondencave me KfW-ne eshte dakorduar qe avanci prej 20% e vleres se kontrates te paguhet 125,000.00 Euro nga MMPH dhe pjesa e mbetur nga Banka Gjermane KfW..*(Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi).*

*Sa i perket pjeses se dyte te fazes se dyte te projektit te ujerave te Zeza qe ka te beje me Masat Shoqeruese si dhe kemi me raportuar me heret jane parakualifikuar 5 kompani. Keto kompani i kan dorezuar ofertat teknike dhe financiare dhe jemi ne fazen e avluimit te pjeses teknike. Deri me date 10 Korrik 2015 besojme qe do te shpallet edhe kompania fitueses per kete projekt *Per me gjeresisht*

raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi dhe e posedojme raportin periodok ne te cilin jane pershkruar te gjitha aktivitetet ne lidhje me kete projekt).

*Sa i perket Fazes se Pare qe ka te beje me ndertimin e kolektorit kryesor ne anen e djathte te rrjedhjes se lumbardhit dhe rehabilitimin e disa pikave problematike ne lagjen kurilla dhe ne zonen industriale: Punimet ne teren per fazen I kan filluar me 23.06.2015, kurse plani dinamik i fillimit te punimeve eshte perditesuar dhe zyrtarisht fillon me 01.05.2015. Deri me tani eshte duke u punuar ne pjesen A te kolektorit ku dhe qe nga dita e fillimit e deri me tani jane vendosur rreth 750m gyp. Sa i perket monitorimit te punimeve ne teren cdo dite jemi prezent ne dhe Konsulenca e projektit, ku dhe mbahen takime javore ne lidhje me ecurine e projektit te cilat dhe i posedojme. *(Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi dhe e posedojme raportin periodok ne te cilin jane pershkruar te gjitha aktivitetet ne lidhje me kete projekt).*

Sa i perket fazes se dyte te projektit te ujerave te Zeza qe ka te beje me ndertimin e ITUZ-se, kemi marr konfirmimin nga KfW per Kompanine AQUALIA&Hidroterm me te cilen kemi nenshkruar kontraten me date 05.05.2015. momentalisht jemi ne fazen pergaditore per fillimin e punimeve. PasTakimeve qe kemi pas me Kompanine dhe korespondencave me KfW-ne eshte dakorduar qe avanci prej 20% e vleres se kontrates te paguhet 125,000.00 Euro nga MMPH dhe pjesa e mbetur nga Banka Gjermane KfW. Aqualia&Hidroterm ka per te hapur kompanine me seli ne kosove dhe ne momentin qe do te dorezohjet fatura per pagesen e avancit prej 20% atehere do te realizohet pagesa..(Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi).*

*Sa i perket pjeses se dyte te fazes se dyte te projektit te ujerave te Zeza qe ka te beje me Masat Shoqeruese si dhe kemi me raportuar me heret jane parakualifikuar 5 kompani. Keto kompani i kan dorezuar ofertat teknike dhe financiare dhe jemi ne fazen e avluimit te pjeses teknike. Deri ne fund te muajit Korrik 2015 besojme qe do te shpallet edhe kompania fitueses per kete projekt *Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi dhe e posedojme raportin periodok ne te cilin jane pershkruar te gjitha aktivitetet ne lidhje me kete projekt).*

Raport për trajtimin e Ujërave të Zeza TM3

Sa i perket Fazes se Pare qe ka te beje me ndertimin e kolektorit kryesor ne anen e djathte te rrjedhjes se lumbardhit dhe rehabilitimin e disa pikave problematike ne lagjen Kurilla dhe ne zonen Industriale:

Punimet ne teren per fazen i kane filluar me 23.06.2015. Deri me tani kane perfunduar punimet per pjesen A te kolektorit ku dhe qe nga dita e fillimit e deri me tani jane vendosur rreth 1800m gyp, gjithashtu jane instaluar 36 puseta .

Sa i perket monitorimit te punimeve ne teren cdo dite perfaqesuesit e HRJ jemi prezent dhe Konsulenca e projektit, ku dhe mbahen takime javore ne lidhje me ecurine e projektit te cilat dhe i posedojme. *(Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi dhe e posedojme raportin periodok ne te cilin jane pershkruar te gjitha aktivitetet ne lidhje me kete projekt).*

Sa i perket fazes se dyte te projektit te ujerave te Zeza qe ka te beje me ndertimin e ITUZ-se, kemi marr konfirmimin nga KfW per Kompanine AQUALIA&Hidroterm me te cilen kemi nenshkruar kontraten me date 05.05.2015. momentalisht jemi ne fazen pergaditore per fillimin e punimeve. Pas takimeve qe kemi pas me Kompanine dhe korespondencave me KfW-ne eshte dakorduar qe avanci prej 20% e vleres se kontrates te paguhet 625,000.00 Euro nga MMPH dhe pjesa e mbetur nga Banka Gjermane KfW. Aqualia&Hidroterm ka per te hapur kompanine me seli ne Kosove dhe ne momentin qe do te dorezohjet fatura per pagesen e avancit prej 20% atehere do te realizohet pagesa.(Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi).*

*Sa i perket pagesave ne lidhje me Fazen i perpos pageses se avancit prej 20% te vleres se kontrates ende nuk eshte bere ndonje pagese tjeter, sipas takimeve qe kemi pas me kontraktktorin jemi dakorduar qe te pergaditet pozicioni i per pages ne nje fature te vetme e cila do te perfshije punimet e realizuara prej fillimit e deri ne muajin Tetor. *(Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi dhe i posedojme raportet javore , mujore dhe raportin periodok ne te cilin jane pershkruar te gjitha aktivitetet ne lidhje me kete projekt).*

Pagesa e avancit nga kontributi vendor do te realizohet ne muajin tetor ne si AEP e kemi dorezuar kerkesen per terheqjen e mjeteve ne MMPH.

*Sa i perket fillimit te punimeve jane duke u bere parapergaditjet mobilizueses dhe kompania kontraktuese ka derguar situacionin e vendosjes se paisjeve per ITUZ, si dhe jane duke dizajnuar projektin detal i cili do te jete i domosdoshem per aplikimin ne MMPH per dhenien e pelqimit ne departamentin e ndertimit brenda MMPH-se. *(Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi).*

*Sa i perket pjeses se dyte te fazes se dyte te projektit te ujerave te Zeza qe ka te beje me Masat Shoqeruese si dhe kemi me raportuar me heret jane parakualifikuar 5 kompani. Keto kompani i kane dorezuar ofertat teknike dhe financiare dhe jemi ne fazen e avluimit te pjeses teknike. Deri ne fund te muajit Nentor 2015 besojme qe do te shpallet edhe kompania fitueses per kete projekt. *(Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi dhe e posedojme raportin periodok ne te cilin jane pershkruar te gjitha aktivitetet ne lidhje me kete projek).*

Raport për trajtimin e Ujërave të Zeza TM4

Faza e pare I e projektit

“Ndertimi i Kolektorit Kryesor”

- **Të dhënat Teknike**

-Gjithsejt gjatesia e kolektorit qe do te instalohet eshte rreth 5100m.

- Diematri i kolektorit fillon nga DN500mm deri ne DN1200mm ne hymje te ITUZ-se dhe DN 1000mm ne dalje te ITUZ-se. Tipi i gypit eshte HDPE i brinjeluar SN8 (CL 8kN/m2) dhe Gize K9

- Kolektori do te vendoset ne rruge ne anen e djathte te rrjedhjes se Lumbardhit dhe do te te vendoset ne vendin e kolektorit te vjeter, ku do te perfshije keto rruge: Enver Haradinaj, Remzi Ademaj, pjeserisht Wiliam Wolker, Rrugen magjistrale M25 deri tek ITUZ, ndersa vazhdimi i kolektorit nga rrethi i fshatit Hoqe e Qytetit deri tek kyqeja Jugore e Autostrades do te kaloje ne mes te rruges M25 pastaj nga ky pozicion do te vazhdohet deri tek kyqeja ne ITUZ.

Çmimi

-Vlera e punimeve sipas kontrates se nenshkruar ne mes te PASSAVNTE dhe KRU” Hidroregjioni Jugor” Sh.A eshte: 2,043,273.00 Euro.

Afati (data) i fillimit te punimeve

-Sipas planit dinamik te pershkruar ne kontrate punimet duhet te fillojne te Henen me 15.12.2014 dhe duhet te perfundojne te Henen me 12.12.2016, mirpo per shkak te vonesave ne rregullimin e pelqimeve dhe lejeve te cilat jane te domosdoshme per fillimin e punimeve kemi pasur ngecje ne fillimin e realizimit te punimeve ne teren.

-Perfundimisht pas marrjes se te gjitha pelqimeve dhe Lejes nga Drejtoria per Planifikim dhe Urbanizem punimet kane filluar me date 06.06.2015 pasi qe eshte bere furnizimi me material konform kontrates.

Progresi i punimeve ne Faza e pare I te projektit

Ne Pjesen A (Task A) deri me tani jane realizuar hapja e kanalit, vendosja e zhavorit, vendosja e gypave, mbulimi i kanalit te gjitha keto sipas detaleve te dhena ne projekt dhe ate;

Instalimi i Gypave te kolektorit 1265 m.

-Gypi DN800mm HDPE i brinjeluar SN8 (CL 8kN/m2) L=1215 m,

-Gypi DN1000mm HDPE i brinjezuar SN8 (CL 8kN/m²) L=1300 m,
Instalimi i pusetave nga P101 deri P151 gjithsej 150 puseta, si dhe te gjitha pjeset percjellese.



Fig 1. Punet ndertimore Task A, P117 to P12

- Kane perfunduar punimet ne ndertim te pusetes shkarkuese (kaperderdhesit) CSO S1 tek rrethi i fshati Hoqe e Qytetit, ku ky kaperderdhes eshte ndertuar brenda trupit te rruges M25 dhe njeherit bene lidhjen e kolektorit ekzistues me ate te kolektorit te ri.



Fig 2. Punet ndertimore Task A, CSO 1

Obligimet ndaj kontraktorit

Ne baze kontrates se nenshkruar ne mes te PASSAVNTE dhe KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A eshte realizuar edhe pagesa e avansit me vler 20% te kontrates mjete keto te siguruar nga Qeveria e Republikes se Kosoves permes ministris se linjes MMPH.

Sa i perket furnizimit me material nga kontraktori ne si Hidroregjion kemi bere kerkesat e duhura ne MZHE per mundesine e lirimit nga taksat doganore, i kemi derguar ne MZHE te gjitha dokumentet e nevojshme ne lidhje me mundesine e lirimit nga Taksat doganore per pjesen qe do te financohet nga KfW.

Momentalish kane filluar punimet tek CSOS1g te Marashi dhe kolektori te lokacioni i ETC-se Eshte nenshkruar IPC 1-Fatura e pare per pune kryerje te Fazes I nga ana jone dhe eshte derguar tek Passavante, e cila pastaj duhet te dergohet tek KfW pasi qe kjo pagese do te kryhet nga KfW. Kontigjenti i dyte per Fazen I i furnizimit pas kerkeses sone dhe plotesimit te dokumentacionit perkates ne MZHE, eshte liruar nga TVSH-ja.

Faza e dyte II e projektit:

"Dizajnimi dhe ndertimi i Impiantit per trajtimin e ujerave te zeza"

- Projekti ka të bëjë me dizajnimin dhe ndërtimin e ITUZ-së, per realizimin e ketij projekti me date: 05.05.2015 eshte nenshkruar kontrata ne mes te kompanise AQUALIA nga Spanja si dhe KRU" Hidroregjioni Jugor" Sh.A, vlera e kontrates eshte 10,354,512.41 EUR .

Sipas marrevshjes kontraktuale per kete porjket duhet te paguhet avanci me vlere prej 20% e vleres se kontrates, pagese te cilen duhet ta paguaj MMPH.

-Deri me tani konform marrevshjes speciale te reviduar nga ana e kontributit vendor jane paguar ne emer te avansit per Fazen II, 625,000.00 Euro kurse pjesa e mbetur duhet paguar nga KfW.

Bazuar ne Marrevshjen e vecant ne te cilen eshte qartesuar planifikimi i mjeteve per kontributin vendor dhe kontributin e jashtem, eshte riplanifikuar buxheti i kontributit vendor ku dhe sipas minutave te takimit te dates 14 Tetor 2015 te nenshkruar nga MMPH, Komuna e Prizrenit, HRJ dhe KfW eshte parapare:

Kontributi vendor

| | | | | |
|------|------|----------------------|---------|-------------------|
| 2014 | Euro | FAZA I | | 99,763.70 |
| 2015 | Euro | Pjesa e pare e vitit | FAZA I | 374,275.82 |
| 2015 | Euro | Pjesa e dyte e vitit | FAZA II | 625,000.00 |
| 2016 | Euro | | | 2,500,000.00 |
| 2017 | Euro | | | 1,400,960.48 |
| | | | | ===== = |
| | | | | 5,000,000.00 EURO |

Aktivitetet e ndërtimit Faza 2

Kontraktori ka finalizuar çështjet e mobilizimit dhe ato administrative. Faturat e pagesës së avansit eshte dorëzuar.

Tani kontraktori është duke punuar në projekt,

- përditësimi i trasesë (layout) së Impjantit për Trajtimin e Ujërave të Zeza në bazë të kërkesave të punëdhënësit,
- përgatitja e orarit të projektimit dhe planit dinamik është në progress,
- kordinimi për zhvendosjen e linjës së rrymës elektrike mbitokësore me KEDS-in,
- kordinimi i pikave kyqëse të furnizimit me rrymë për Impjantin për Trajtimin e Ujërave të Zeza me KEDS-in,
- kontraktori do të angazhojë një kompani për të bërë matjet gjeodezike.

Periudha e projektimit është 120 ditë. Për të shmangur vonesat për shkak të dokumenteve jo të kënaqshme të projektit, është pajtuar që të dorëzohen projektet në pako.

Pakoja e parë – Projekti Konceptual i Azhurnuar u dorëzua me 24 Korrik

- Që përbëhet nga një vizatim i trasesë (layout), P&ID, profil hidraulik.

Pakoja e dytë – Projekti Kryesor pritet me datën 30 Shtator

- Vizatimet që kërkohen për marrjen e lejes për projektet e kategorisë III, p.sh. projektet civile për të gjitha strukturat dhe njësitë, të gjitha vizatimet layout (të përgjithshme, gypat, rryma, rrugët, hapësira, etj), vizatimet e azhuruara të projektit konceptual. Ku kjo pako është prezantuar në takimi e fundit të mbajtur në HRJ në fillim të muajit Nentor 2015

Pakoja e tretë – Projekti i Detajuar pritet të jetë pjesërisht krahas me progresin në ndërtim.

- Vizatimet detale që kërkohen për ndërtimin e secilës njësi/ndërtesë/strukturë, duke përfshirë kalkulimet statilke, lista e paisjeve etj. (krahas progresit të projektit).

-Në takimin e fundit gjatë muajit tetor kemi patur një takim me kontraktorin e Fazës II dhe Konsulencën ku dhe kemi diskutuar në lidhje me shtrirejen-situacionin e brendshëm të impiantit, që nënkutpon metodën e trajtimit, shtrirejen e objekteve administrative dhe përcjellese, dhe pritet miratimi nga ana e HRJ-se.

-Punëdhënësi HRJ ka shprehur gadishmërinë për t'i asistuar Kontraktorit në të gjitha çështjet për të marrë lejet e kërkuara. Ligjet relevante dhe udhëzimet administrative iu janë dhënë Kontraktorit.



Pamja e ITUZ-se në 3D

-Për shkak të pengesave nga pronaret e shpronësuar nuk ka aktivitete të ndërtimit deri më tani

-Në bashkë me konsulencën dhe kontraktorin në një takim në zyrën e DSHP-se dhe përmes një shkresë elektronike e kemi njoftuar DSHP në komunën e Prizrenit, për pengesat që i kemi nga

pronaret e shpronësuar të lokacionit ku do të ndërtohet ITUZ dhe kemi kërkuar nga DSHP si bartese e projektit për shpronësim që të ndermarre masat e duhura që mos të ngecim me projektin në fjalë pasi që çdo vonesë do të reflektoje në kosoton e projektit si dhe do të rrezikojë investimin në përgjithësi.

-Pas bisedës telefonike që kam pas me zyrtarin komunal në zyrën e pronave në komunën e Prizrenit, z. Gursel Skenderi, më është thënë se pa u paguar edhe centi i fundit tek [pronaret në nuk kemi të drejtë që pronat e tyre të bartim tek Komuna.

-Sa i përket lejes së ndërtimit të cilen duhet ta kërkojmë tek Departamenti i ndërtimit në MMPH, paraprakisht duhet nxjerrë dokumenti i VNM-së, i cili po ashtu kërkon kriterin kryesor shpronësimit të lokacionit, prandaj në rast se kemi pengesë në pagesën e pronave, komuna e Prizrenit duhet të krijojë një KONTA MIREBESIMI në të cilën duhet të derdhet të gjitha mjetet e parapara për shpronësim dhe në momentin që do ta kemi këtë dokument do të fillohet me përpilimin e VNM-së si kusht kryesor për posedimin e lejes së ndërtimit nga MMPH.

-Përpos takimeve për mbarevajtje të punimeve nuk kemi patur ndonjë progres të theksuar në lidhje me Projektin në fjalë,

Pas takimit me Drejtorin e shërbimeve publike në një konferencë i njëjti gojarisht më tha që sa i përket kontos së mirebesimit ajo do të nxjerret nga komuna vitin e ardhshëm në fillim të 2016-tës.

2.1.9 Furnizimi në Njësit Punuese

Aktivitetet Janar-Dhjetor, 2015 - Njesia Prizren

Furnizimi me ujë ka qenë i rregullt në përgjithësi, përveq në disa raste kur ka pasë ndonjë ndërhyrje në mirëmbajtje në rrjet të ujësjellësit dhe gjatë punimeve për pastrimin e ujëmatësave.

Prodhimi i ujit: gjatë muajve Janar-Dhjetor, janë prodhuar 13,641,242.00m³ ujë ose 432.6 l/s dhe kjo sasi ka kushtëzuar furnizim të rregullt për të gjithë konsumatorët përveq në lagjet me sistem pompimi Bazhderhanen, Dardanin dhe pjesën e eperme të Tusuzit.

Humbjet e ujit: humbjet e ujit arrijnë në 58.03% për shkak të rrjetit të vjetër të ujësjellësit, dhe ndërhyrjeve të pa legalizuara.

Operacionët e mirëmbajtjes së ujësjellësit dhe kanalizimit:

Gjatë muajve Janar-Dhjetor furnizimi me ujë ka qenë i rregullt 24 orë në zonat e ulta dhe me reduktime në lagjet Dardania, Bazhderhane dhe Tusuz.

Gjatë muajve Janar-Dhjetor është planifikuar në bazë të kërkesës është bërë furnizimi me material dhe është rregulluar tabela elektrike e puseve tek livadhi ku janë testuar dhe lidhur në rrjet dhe janë të gatshëm në rast të nevojës, kurse tek 40-Burime është bërë matja e kanalit dhe planifikimi për shtruarjen e rrjetit.

Është hartuar projekti dhe realizuar për shtrirjen e gypit Ø 700 një pjesë dhe Ø 300 pjesa tjetër nga kaptazha e re.

Është përfunduar projekti për fsh. Atmaxhë dhe në lagjen e Spaqve ku edhe janë ndërprerë plasaritjet e gypit të cilat kanë ndodhur me heret.

Gjatë muajve Janar-Dhjetor janë paraqitur probleme në energjinë elektrike tek Mulliri dhe tek Vermica ku edhe janë eliminuar problemet.

Gjatë muajit Prill është përfunduar projekti për rrugën „Hysni Morina“ ku janë bërë ndërrimi i rrjetit, pregaditja, gropimi, transporti, mbushja e kanalit me rërë etj.

Është përfunduar hartimi i projekti për Kazerm me të cilin projekt ndërpriten plasaritjet e gypit të cilat kanë ndodhur me heret.

Me rastin e lidhjes së marrëveshjes me KFOR ku financues për gypa ka qenë KFOR-i është bërë ndërrimi i gypit Ø 315 me një gjatësi prej 650 metrave ku pjesërisht është ndërruar gypi transportues Ø 315 me një gjatësi prej 250 metrave që kalon nëpër Kazerm dhe gypi furnizues Ø 315 me një

gjatesi prej 400 metrave që bënë furnizimin e lagjeve Bazhderhana, Dardania dhe rrugen e Janines. Është vazhduar me ndrrimin e gypit Ø 315 mm jasht Kazermës.

Ka përfunduar projekti për Kazerm ku edhe janë ndërprer plasaritjet e gypit të cilat kanë ndodhur më herët.

Gjatë muajve të verës, kanë vazhduar keqperdorimet e ujit për arsye të ujitjeve dhe është vërejtur dukshem mungesa e ujit nëpër fshatra dhe lagje të cilat kanë mbetur pa ujë.

Kemi pasur plasaritje të gypit Ø 400 ku është sanuar defekti

Janë marr disa hapa konkret lidhur me sanimet klolektive ku në kordinim me komunitetin, Komunën dhe Hidroregjionin Jugor janë ndërruar gypat e furnizimit në disa rrugica si rruga Mihael Grameno, Rruga Perveza, banesat e Solidaritetit.

Rruget të cilat janë përfunduar, gypin e ka furnizuar Komuniteti punet teknike Kompania kurse shtrirjen e rruges me kubza e ka krye Komuna.

Ka përfunduar projekti në fazen e parë rehabilitimi i rrjetit në rruget qendrore të qytetit ku ka përfunduar puna në rrugen Halil Berisha.

Nga ana e njësisë janë disloku disa kyqje të cilat nuk ishin planifikuar ku në njëren prej rrugicës ka pas gyp të azbestit të cilat kanë qënë të lidhura në gypin e vjeter të azbestit dhe janë lidhur në gypin polietilen si dhe është eliminuar krejtësisht gypi i azbestit i cili ka funksionuar deri tani para lidhjes së Eurocentrit.

Janë marr të gjitha veprimet për sigurimin e lejes për fillimin e punimeve në sheshin Shatervan ku janë siguruar të gjitha lejet perveq nga drejtoria e kultures ku me inicimin e drejtoris së kultures është formuar komisioni dhe në ditet e ardhshme presim me dal në vendëngjarje dhe me marr lejen perkatese nga ministria e kultures.

Në kordinim me kuvendin Komunal, Hidroregjionin Jugor dhe komunitetin, pas hartimit të projektit per lagjen Desave, janë realizuar punimet dhe ka përfunduar projekti në tërësi.

Pas aksidentit me zjarr njesia e Prizren-it ka bërë pastrimin e mbeturinave dhe instalimin e rrymes.

Të gjitha ankesat nga ana e konsumatorët janë shqyrtuar dhe të gjitha kanë përfunduar me eliminimin e defekteve të ndryshme.

Në rrjetin e ujësjellsit janë bërë **1094** raste, ndërsa në rrjetin e kanalizimit **734** raste.

| Gjithsej aktivitete në ujësjellës Janar-Dhjetor | | |
|---|-----------------------------------|------|
| 1 | Defektet ne rrjetin sekundar | 930 |
| 2 | Defektet ne rrjetin primar | 164 |
| 3 | Defekte ne komplet rrjetin | 1094 |
| 4 | Bartja e ujit me cistern | 95 |
| 5 | Pastrimi dhe fryerja me kompresor | 101 |

| Gjithsej aktivitete në kanalizim Janar-Dhjetor | | | |
|--|-----------------------|-------|----------------|
| 1 | Kontroll i pusetes | 1386 | copë |
| 2 | Pastrim i pusetes | 734 | copë |
| 3 | Kontroll i kanalizimi | 27343 | metra |
| 4 | Pastrim i kanalizimi | 15200 | metra |
| 5 | Ndërrim i pusetes | 23 | copë |
| 6 | Ndërrim i kanalizimi | 32 | metra |
| 7 | Riparim i rrugës | 662 | m ² |

Trajtimi dhe klorifikimi:

Këto veprime bëhen pa ndërprerje dhe analizat e ujit nga Enti Higjenik Regjional janë në bazë të raporteve mujore

Shërbimi i përpunimit dhe kontrollit të kualitetit të ujit

- Përcjellja permanente e procesit të klorifikimit në Qytet dhe regjion (fshatra dhe sipas nevojës edhe në njësit tjera si Suharekë, Malishevë e Dragash).
- Marrja e mostrave në Qytet, Njësi (si „Hidroregjion Jugor”) dhe në Fshatra të cilat menagjohen nga ana jonë dhe punimi i tyre në laboartorin tonë.
- standardeve të ujit të pijes. Mostrat janë marrun si vijonë:
- Marrja e mostrave **Fiziko-Kimike**
- Marrja e mostrave **Bakteriologjike**

Aktivitetet Janar-Dhjetor, 2015 - Njesia Suharekë

**Furnizimi me ujë Janar-Dhjetor -2015*, ka qenë pa reduktime pothuajse në tërë zonën e shërbimit, duke përjashtuar ndonjë ndërprerje të shkurtër për shkak të ndonjë problemi me pompa, ose për shkak të problemeve me rrymë.

Reduktimi në furnizim me ujë ka filluar në muajin Korrik, duke vazhduar në Gusht dhe Shtator, për shkak të thatësisë që ka mbretëruar gjatë këtyre muajve dhe keqpërdorimit të ujit të pijes nga konsumatorët për destinime tjera.

Edhe më tutje kemi furnizim jo adekuat në periferi të qytetit të Suharekës dhe atë për shkak të nivelit të ultë të bazenit në Shirokë, prej nga furnizohet qyteti dhe si pasojë kemi shtypje të ultë, ndërsa në pikat më të larta fare nuk ka furnizim.

**Analizat e ujit - Janar-Dhjetor /2015*, janë realizuar 67 (të paktën janë paraqitur tek njësia jonë) mostra të analizave bakteriologjike dhe 67 mostra i'u kanë përgjigje standardeve sipas Institutit të Shëndetit Publik.

**Rregullimi i defekteve - Janar-Dhjetor /2015*, është intervenuar 370 defekte, rrjeti primar ka pasur 1 defekt, 299 në rrjetin sekondar dhe në kyqjet individuale, 70 deblokime të kanalizimit, zëvendësimi i ujëmatësve 5, stacionet e pompimit (janë djegur katër pompa te Pusi Atit), rregullimi i kubëzave 184 [m²], rregullimi i anësoreve 30 [m] gjatësi si dhe 55 kyqje të reja në ujësjellës ku punët e montimi i ka kryer kompania.

**Pastrimi i rezervuarëve të ujit dhe puseta të kanalizimit* - janë pastruar dhe dezinfektuar rezervuarët e ujit në Savrovë dhe Mushtisht, 35 puseta të kanalizimit në Suharekë, 30 puseta të kanalizimit në Reshtan, 15 puseta të kanalizimit në Shirokë (zona industrial), 10 puseta të kanalizimit në rrugën e vjetër të Peqanit, 20 puseta të kanalizimit në Samadraxhë.

**Kyqje në rrjetin e ri të ujësjellësit në fshatrat:*

-Zgjerimi i rrjetit të ujësjellësit në Shirokë, hapja e kanalit me gjatësi L=200[m] dhe shtrirja e gypit Ø90[mm] në gjatësi 150[m] dhe Ø63[mm] në gjatësi 50[m].

Hapja e kanalit me gjatësi L=400[m] dhe shtrirja e gypit Ø90[mm] dhe Ø63[mm].

-Zëvendësimi i rrjetit të ujësjellësit në rrugën Shirokë-Sopijë, ku është hapur kanali me gjatësi L=90[m] dhe janë shtrirë 90[m] gyp Ø75[mm].

-Në bashkëpunim me Komunën janë duke u kryerë punimet në rrjetin e ri të ujësjellësit në fshatin Mushtisht.

Punët e gërmimit janë duke u kryerë nga një kompani private e kontraktuar nga Komuna për rregullimin e rrugës si dhe montimin e pusetave jashtë oborreve të konsumatorëve, ndërsa punët në furnizimin dhe montimin e pjesëve për kyqje të konsumatorëve jemi duke i kryerë njësia jonë. Lidhjet janë bërë në gypin e ri nga PE me diametër Ø 90 mm, ndërsa pjesët fazonike dhe ujëmatësit janë të furnizuar nga depo e ujësjellësit. Ritmin e punimeve po e dikton kompania private e cila po bënë gërmimet.

-Në bashkëpunim me Komunën e Suharekës është bërë vendosja e gypit të ri në një pjesë periferike të fshatit Semetishtë, me gjatësi 200 m dhe diametër të gypit \varnothing 63mm, punët e gërmimit janë duke u realizuar nga kompania jonë K.R.U “ Hidroregjioni Jugor” ndërsa furnizimi me gypë dhe pjesë fazonike janë të financuar nga komuna, deri më tani, janë realizuar 4 lidhje të reja, në këtë pjesë të gypit.

-Doberdelan - në bashkëpunim me banorët e fshatit, është bërë vendosja e gypit të ri në një pjesë periferike të fshatit, me gjatësi 200 m dhe diametër të gypit \varnothing 50 mm, punët e gërmimit janë duke u realizuar nga kompania jonë K.R.U “ Hidroregjioni Jugor” ndërsa furnizimi me gyp dhe pjesë fazonike janë të financuar nga banorët, deri më tani, janë realizuar 4 lidhje të reja.

-Vendosja e gypit të ri \varnothing 90mm PE, me gjatësi L=1500m, në fshatin Sopi - Në bashkëpunim me Komunën është duke u bërë vendosja e gypit të ri dhe krijimi i 10 daljeve sekodare nga gypi kryesor. Punimet e gërmimeve dhe furnizimi me material është bërë nga Komuna e Suharekës ndërsa punët montuese janë realizuar nga kompania.

Verejtje : Kjo pjesë për momentin ka mundësi të furnizimit me ujë të pijes, për arsye se gjendet në lartësi të madhe nga pika e furnizimit të fshatit.

* Zëvendësimi i rrjetit të ujësjellësit nga \varnothing 63[mm]PVC në \varnothing 90[mm] PE me gjatësi L=850 [m] në fshatin Studenqan

-Në bashkëpunim me Komunën është duke u bërë zëvendësimi i gypit ekzistues të ujësjellësit dhe realizimi i kyçjeve individuale të konsumatorëve.

Në bazë të marrëveshjes në mes të njësisë tonë dhe Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Komunës, punët e gërmimit të kanaleve dhe furnizimit me gyp dhe pjesë të nevojshme për ujësjellës janë marrë përsipër nga Komuna, kurse njësi jonë kryen vetëm punët në instalimin e rrjetit, ku deri më tani janë realizuar 63 kyçje në rrjetin e ri, konsumatorë që kryesisht kanë qenë të kyçur edhe më herët në rrjetin e mëparshëm.

-Studenqan – në bashkëpunim me banorët e fshatit, është bërë vendosja e gypit të ri në një pjesë periferike të fshatit, me gjatësi 200 m dhe diametër të gypit \varnothing 50 mm, punët e gërmimit janë duke u realizuar nga kompania jonë K.R.U “ Hidroregjioni Jugor ” ndërsa furnizimi me gyp dhe pjesë fazonike janë të financuar nga banorët, deri më tani, janë realizuar 6 lidhje të reja.

-Zëvendësimi i rrjetit të ujësjellësit në Qendrën Zejtare II - është bërë ndërrimi i rrjetit të ujësjellësit në Qendrën Zejtare II, me investime nga Komuna e Suharekës, përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike, ndërsa vendosjen dhe lidhjen e rrjetit e ka bërë kompania jonë. Me këtë projekt është përmirësuar dukshëm furnizimi me ujë dhe janë zvogëluar humbjet teknike, është krijuar një presion optimal tek konsumatorët.

Aktivitetet Janar-Dhjetor, 2015 – Njesia Malishevë

*Gjatë muajve Janar-Dhjetor -2015, furnizimi me ujë ka qenë i plotë gjatë 24 orëve në të gjithë zonën e shërbimit ku ne i menaxhojmë, me përjashtim të rasteve kurë ka pasur reduktime të energjisë elektrike pasi gjithë furnizimin e kemi me pompa.

*Analizat e ujit – Janar-Dhjetor -2015, janë realizuar 60 (të paktën janë paraqitur tek njësi jonë) mostra të analizave bakteriologjike dhe 60 mostra të analizave fiziko-kimike dhe sipas rezultateve të gjitha iu kanë përgjigjur standardeve.

*Aktivitete lobimi - kontakte të rregullta me Kryetarin e Komunës, Drejtorët e Drejtorive Komunale si ato të Shërbimeve Publike, të Inspektoriatit, të Urbanizmit dhe me Drejtorin e Financave, me qëllim të bashkëpunimit dhe bashkeveprimit në realizimin e të gjitha projekteve që janë në fushën e menaxhimit të ujerave.

*Takime të rregullta me përfaqësuesit e fshatit Drenoc ku edhe janë duke vazhduar ende punimet në ndërtimin e pusetave, montimin e ujëmatësave si dhe kyqjet individuale nga N.N.BELI. Investitorë: K,K.Malishevë dhe kisha katolike Amerikane .

*Hulumtimi i burimeve të reja të ujit në fshatin Pagarushë ku janë hapur 3 puse L=210m thellesi dhe janë konstatuar rreth 40l/s. Nga këto burime planifikojmë të furnizojmë me ujë banoret e fshatrave: Pagarushe, Gurishtë dhe Marali =5600 banorë.

Investim i Komunës së Malisheves 13.000 €

*Jemi në kontakte të vazhdueshme me zyrtarët komunal si dhe me investitorët CDI, për realizimin e projekteve të planifikuara për periudhën 2015-2017 që do të implementohen në dy faza: Faza e parë është Rehabilitimi i sistemeve ekzistuese të ujesjellesave në zonat rurale ku planifikohen të funksionalizohen ujesjellesit në 11 fshatra të komunës së Malisheves e ku do të përfitojnë 15.000 banorë.

*Faza e dytë është Ndërtimi i sistemit të ri të ujesjellesit në fshatin Senik ku aty janë hapur gjashtë puse dhe kemi siguru sasinë e ujit mbi 60 l/s.

Me këtë sasi të ujit planifikojmë të furnizojmë me ujë të pijes 12 fshatra të komunës së Malisheves ose rreth 25.000 banorë .

*Takim me përfaqësuesit e kompanisë N.N.BELI, për projektin Ndërtimi i Galerive ujëmbledhëse në fshatin Senik, ku sipas kërkesës që është bërë nga ana e kompanisë, është bërë ndërprerja e punimeve për shkak të pengesave gjatë ekzekutimit nga pala e tretë.

*Takim me përfaqësuesit e kompanisë N.N.QENDRIMI, për projektin Rinovimi i Kanalizimeve në fshatrat e K.Malisheve, ku janë duke vazhduar punimet në këtë projekt.

*Takim me përfaqësuesit e kompanisë N.N.SH "BURIMI", ku është bërë kërkesa nga ana e kompanisë në fjalë për formimin e komisionit për pranimin teknik në projektin Hapja e puseve pizometër si dhe eksplotuse në fshatrat e K.Malisheve.

**Rregullimi i defekteve - Janar-Dhjetor -2015.*

Rrjeti primar 173 defekte, rrjeti sekondar 245 defekte, deblokimi i kanalizimeve 166 ndërhyrje dhe 21.40 km kanal të pastruar, ankesat teknike 31, ankesat komerciale 58, kontrata të lidhura 85, njoftime për shkyqje 1084, shkyqje për mos pagesë 23, kyqje ilegale 27, shkyqje të kyqjeve ilegale 26, rikyqje 14, kyqje të reja 258, amvisëri 240, lokale 18, nr.i bllobave 699, procesverbale të shkyqjeve 37, verifikim të ujëmatësave 1961, ujëmatës të ndërruar 57, ujëmatës të montuar 41.

Aktivitetet Janar-Dhjetor, 2015 - Njesia Dragash

*Furnizimi me ujë - Janar-Dhjetor -2015, ka qenë i rregullt në përgjithsi, këtë situat stabile e kanë mundësuar aktivitetet të cilat kanë ndodhë gjatë këtij muaji, fillimisht me sigurimin e mjaftueshëm të ujit për trajtim, pastrimin e pusetave dhe punë tjera në kaptazhë në fshatin Radesh. Është pastruar edhe disa herë kaugullatori sipas nevojës.

*Trajtimi i ujit (sendimentimi,kaugulimi,filtrimi dhe klorizimi) është bërë në vazhdimsi.

*Aktivitete nga ekipi teknik në operativë janë bërë këto: 19 kyqje në ujësjellës, 39 pastrim i pusetave të kanalizimit, 770m deblokim dhe pastrim në rrjetin e kanalizimit, 3 sanim në rrjetin e kanalizimit, 54 raste sanim në rrjetin e ujësjellësit, 1 shkyqje në rrjetin e ujesjellesit, 1 rikyqje në rrjetin e ujesjellesit , 64 ndrrime të ujëmatësave, 21 montime të ujëmatësave të ri, 135 pastrim dhe kontrolle të ujëmatësave, 59 angazhime tjera të ekipit teknik.

*Punët në administratë janë të azhuruara sipas rregullave që i aplikon kompania duke i përfshirë punët nga lëmia e financave dhe atyre të administratës së përgjithëshme.

*Prodhimi i ujit: Janar-Dhjetor -2015, janë prodhuar 383,420.00 m³ ujë dhe kjo sasi ka kushtëzuar furnizim të rregullt për të gjithë konsumatorët.

*Humbjet e ujit: Janar-Dhjetor -2015, arrijnë deri në 50.3 % për shkak të rrjetit të vjetëruar të ujësjellësit.

2.2.1 AKTIVITETET NGA SHËRBIMI RAJONAL PËR KONSUMATORË

Aktivitetet kryesore

Është bërë leximi i ujëmatësve nga Inkasantët (lexuesit) e terrenit .

Janë shtyp dhe shpërnda faturat e shërbimeve të ujësjellsit mbrenda afatit ligjor te secili konsumatorë.

Janë vizituar nga inkasantët të gjithë konsumatorët në pronat e tyre ku është kërkuar inkasimi i mjeteve për shërbimet e ujësjellsit .

Janë shqyrtuar të gjitha ankesat teknike dhe komerciale të konsumatorëve

Janë shpërnda njoftime për mospagesë të shërbimeve të ujësjellsit te konsumatorët të cilët nuk paguajn faturat dhe atyre që kanë borxhe të mëdha ndaj KRU “ Hidroregjioni Jugor” sha.

Janë bërë kontrole në teren te konsumatorët nga ekipet e kontrollës për mospagesë të borxheve, lidhje jashtë ujëmatësit dhe regjistrime të konsumatorëve të rinj.

Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe

Mos zgjidhja e problemit të rasteve sociale , kjo kategori e konsumatorëve po ndikon në mungesën e inkasimit te kjo kategori e konsumatorëve.

Pamundësia e leximit të ujëmatësve për çdo muaj te një numër i konsumatorëve, nga inkasantët tek shtëpit (pronat) e konsumatorëve, pasi në kohën kur bëhet leximi nuk gjenden në shtëpi apo edhe nuk i hapin dyert për tui mundësuar inkasantëve leximin e orëve (kryesisht te konsumatorët që jetojn në ndërtesa kolektive-banesa).

Moszgjidhja e problemit të borxhit për shpenzimet e ujit mes shitësit dhe blerësit të pronës, pronave të uzurpura që nga pas lufta, pronat që kanë qenë nën administrimin e Agjensionit Kosovar të Pronës.

Borxhet e ndërmarrjeve të Privatizuara, të cilat refuzohen si borxhe nga Agjensioni Kosovar i Privatizimit. Borxhet të cilat janë pranuar , ende nuk është bërë pagesa e tyre pasi që pritet procesi i Likuidimit të këtyre ndërmarrjeve.

Hapja e puseve te një numër i konsumatorëve të mëdhenj (Spitali Regjional“ Daut Mustafa” , “ Abi Elif” , “ Remateks” , kanë zvogëlu sasin e ujit të faturuar e me këtë edhe zvoglim të mjeteve të inkasuara.

Masat e realizuara/ mosrealizuara nga periudha paraprake

Rritje të numrit të konsumatorëve në zonën e shërbimit si rezultat i legalizimit të konsumatorëve ilegal apo edhe pëlqimeve për kyqje.

Kemi një rritje të ujit të faturuar në krahasim me vitin paraprak si rezultat i rritjes së numrit të konsumatorëve në zonën e shërbimit

Vonesa në implementimin e Ligjit për Faljen e Borxheve, ka bërë që konsumatorët të hezitojn në pagesën e obligimeve të tyre (TM1, TM2 dhe TM3), ndërsa pas fillimit të implementimit kemi rritje në inkasim si rezultat i vendimit te qeveris mbi faljen e borgjit ku konsumatorët bëjn kontrata ose e paguajn menjher (TM4).

Masat e propozuara për periudhën në vazhdim

Trajtimi i një numri më të madh të konsumatorëve në faljen e borxheve

Vazhdimësia e mbeshtetjes së inkasantëve nga ekipi i kontrollës te konsumatorët të cilët në vijimësi nuk paguajn faturat

Mbikqyrja dhe monitorim i vazhdueshëm i inkashtëve në arritjen e limitive në inkasim
Regjistrimi i vazhdueshëm i konsumatorëve që dëshirojnë të kyqen në shërbime të ujësjellsit dhe kanalizimit

2.2.2 RAPORTIMI EKIPES SË KONTROLLES DHE SHKYÇJES

2014

| Nr. | Njesia Operative | Lidhjet e reja | Ç'kyçjet | Lidhje ilegale | Verifikimi i ujëmatësve | Inkasimi |
|----------|----------------------------------|----------------|------------|----------------|-------------------------|---------------------|
| 1 | Prizren | 1144 | 62 | 57 | 9696 | 179,421.84 € |
| 2 | Suharekë | 969 | 174 | 129 | 3772 | 32,082.84 € |
| 3 | Malishevë | 131 | 72 | 67 | 2052 | 18,510.92 € |
| 4 | Dragash | 17 | 2 | 1 | 101 | 0.00 € |
| 5 | KRU "Hidroregjioni Jugor" | 2.261 | 310 | 254 | 15.621 | 230,015.60 € |

2015

| Nr. | Njesia Operative | Lidhjet e reja | Ç'kyçjet | Lidhje ilegale | Verifikimi i ujëmatësve | Inkasimi |
|----------|----------------------------------|----------------|------------|----------------|-------------------------|----------|
| 1 | Prizren | 1432 | 43 | 20 | 8720 | |
| 2 | Suharekë | 260 | 48 | 49 | 8393 | |
| 3 | Malishevë | 472 | 84 | 68 | 4454 | |
| 4 | Dragash | 22 | 1 | 0 | 56 | |
| 5 | KRU "Hidroregjioni Jugor" | 2.186 | 176 | 137 | 21.623 | |

2.2.3 RAPORTI I ANKESAVE

2014

| MUAJI | JAN | SHKU | MAR | PRILL | MAJ | QER | KORR | GUSH | SHTA | TET | NEN | DHJET | TOTAL |
|--------------|------------|-----------|------------|------------|------------|-----------|------------|------------|------------|------------|-----------|------------|--------------|
| ANK. TEK. | 76 | 55 | 52 | 73 | 68 | 65 | 68 | 90 | 65 | 58 | 45 | 48 | 763 |
| ANK. KOM. | 47 | 40 | 55 | 30 | 48 | 34 | 42 | 25 | 53 | 44 | 30 | 59 | 507 |
| TOTAL | 123 | 95 | 107 | 103 | 116 | 99 | 110 | 115 | 118 | 102 | 75 | 107 | 1.270 |

2015

| MUAJI | JAN | SHKU | MAR | PRILL | MAJ | QER | KORR | GUSH | SHTA | TET | NEN | DHJET | TOTAL |
|--------------|------------|------------|-----------|------------|-----------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|------------|--------------|
| ANK. TEK. | 53 | 49 | 54 | 64 | 60 | 86 | 73 | 84 | 87 | 112 | 86 | 70 | 878 |
| ANK. KOM. | 52 | 51 | 44 | 36 | 26 | 27 | 31 | 38 | 31 | 55 | 54 | 65 | 510 |
| TOTAL | 105 | 100 | 98 | 100 | 86 | 113 | 104 | 122 | 118 | 167 | 140 | 135 | 1.388 |

Koment:

Të gjitha ankesat janë shqyrtuar me kohë. Konsumatorët kanë marrë përgjigje zyrtare nga kompania.

Një numër i konsideruar i ankesave është konstatuar se kanë qenë të babazuara.

2.2.4 RAPORTI I MEDIAVE

Një nga qëllimet kryesore të KRU-“Hidroregjioni Jugor”, (përveç furnizimit me ujë dhe inkasimit, mirëmbajtjes së rrjetit, etj.) është edhe që ta informojë opinionin publik, gjegjësisht konsumatorin për të gjitha ngjarjet që ndodhin në Kompani, apo për problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohet Kompania, gjithashtu ta informojë konsumatorin me kohë, shpejtë dhe saktë për pengesat, ndërprerjet në furnizim apo defekte të ndryshme.

Për t’u realizuar këto qëllime sa më mirë, funksionon zyra për informim dhe zëdhënësi.

Detyrat kryesore të këtyre dy mekanizmave janë që të mblidhen të gjitha informatat në kuadër të kompanisë, gjegjësisht shërbimet përkatëse dhe ato të përpunohen dhe të plasohen në opinionin publik, në mënyrën më të përshtatshme dhe të kuptueshme për opinionin.

Pra, të gjitha informatat që vijnë nga shërbimet e ndryshme, e që janë me interes për konsumatorin, përpunohen dhe përcillen në të gjitha mjetet e informimit.

Në këtë drejtim kemi marrëveshje dhe bashkëpunim të mirë me të gjitha televizionet dhe radiot lokale, gjithashtu nuk mungojnë edhe kontaktet me televizionet qendrore, poashtu edhe me shtypin ditor.

Qëllimi i këtij raporti është nxjerrja në pah e aktiviteteve vjetore të Kompanisë, që kanë të bëjnë me përcjelljen e porosive në opinionin publik.

Zyra për marrëdhënie me publikun, është munduar që nga fillimi i vitit 2015, që përcjelljen e porosisë që del nga KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a., përmes mediave elektronike dhe të shkruara, ta bartë te opinionin publik, në mënyrë sa më të shpejtë dhe sa më të ndershme, njëkohësisht duke mbrojtur interesat e Kompanisë në përgjithësi dhe konsumatorit në veçanti.

Mediat lokale, i kanë kushtuar hapësirë të mjaftueshme KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a. Kanë dhënë kontribut të madh në mënyrë indirekte dhe direkte në ngritjen e shkallës së arkëtimit, në vetëdijësimin e qytetarëve, se uji që shpenzohet duhet kursyer dhe duhet paguar, në informimin e qytetarëve se ujësjellësi i Prizrenit është duke punuar në atë drejtim që t’i përmirësojë shërbimet e veta ndaj çdo konsumatori, se kjo kompani me përkushtimin e saj më të madh, ka arritur që të përfitojë donacione të mëdha nga investitorët e huaj dhe Qeveria e Kosovës, vetëm e vetëm që konsumatorëve të saj t’u ofrojë shërbime sa më cilësore.

Edhe mediat e shkruara kanë dhënë kontribut të mjaftueshëm në shpërndarjen e informacioneve të opinionit publik, lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga KRU-“Hidroregjioni Jugor” sh.a. dhe se hapësira e tyre dhënë kompanisë ka qenë e mjaftueshme.

RAPORT PËR MEDIA

MUAJI: JANAR – DHJETOR 2015

| Nr. | PËRSHKRIMI | MEDIAT | NUMRI TOTAL |
|-----|---|--|-------------|
| 1 | <u>NJOFTIME</u> TV RADIO SHTYPI DITOR | TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI RADIO HELIX RADIO THERANDA LAJM KOSOVA SOT | 31 |
| 2 | <u>INTERVISTA</u> TV RADIO | RTK KLAN KOSOVA TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI TRT TURK | 11 |
| 3 | <u>EMISIONE</u> TV RADIO | TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI | 9 |
| 4 | <u>PËRURIME</u> | TV- BESA TV-OPINION TV-PRIZRENI | 1 |
| 5 | <u>KONKURSET</u> <u>ANULIM I KONKURSIT</u> | LAJM KOSOVA SOT | 15 / |
| 6 | <u>ARTIKUJT-SHTYPI DITOR</u> | KOHA DITORE KOSOVA SOT ZËRI EPOKA E RE | 21 |
| 7 | <u>ARTIKUJT- SHTYPI ELEKTRONIK</u> | www.tv-opinion.com www.prizreni.tv www.rtvbesa.com www.ekonomiaonline.com www.kallxo.com www.kosovasot.info www.prizrenpres.com www.rtklive.com | 61 |

| | | | |
|----|---|--|---|
| | | www.kosovapress.com www.koha.net www.gazetaexpress.com www.zëri.info www.therandapost.com www.malishevapress.com www.botasot.info www.radio-sharri.info www.balkanplus.net www.telegrafi.com www.rtvbesa.facebook.com www.tv-prizreni.facebook.com www.tv-opinion.facebook.com | |
| 8 | <u>VIZITA E ZËVENDËSMINISTRIT SHALA NË KRU"HIIDROREGJIONI JUGOR" - PRIZREN</u> | TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI | 1 |
| 9 | <u>INFORMATË NGA KLAN KOSOVA LIDHUR ME FURNIZIMIN ME UJË</u> | KLAN KOSOVA | 1 |
| 10 | <u>TAKIM ME GAZETARË</u> | TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI | 1 |
| 11 | <u>TAKIM ME "EC MA NDRYSHE"</u> | TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI | 2 |
| 12 | <u>TAKIM ME POLICINË DHE INSPEKTORATIN KOMUNAL PËR KEQPËRDORIM TË UJIT</u> | TV-OPINION TV-BESA TV-PRIZRENI | 1 |

KONKLuzion

KRU-“Hidroregjioni Jugor” Sh.A. Prizren, gjatë vitit 2015, ka dërguar 31 njoftime në mediat elektronike dhe të shkruara, lidhur me aktivitetet që po ndërmerr kjo kompani, filluar nga furnizimi me ujë të pijshëm, aplikimi i shkyçjeve, qoftë kolektive apo individuale , e deri te cilësia e ujit që konsumatorët e marrin në krojet e tyre.

Disa nga njoftimet janë emetuar në televizione, e disa janë publikuar si shkrime në shtypin ditor, duke dhënë çdo herë një mesazh për opinionin publik.

Mediat janë për t'u lavdëruar në shpërndarjen e informacioneve te opinionin publik, lidhur me të gjitha aktivitetet e ndërmarra nga KRU-Hidroregjioni Jugor dhe hapësira e tyre dhënë kompanisë ka qenë e mjaftueshme.

Mbulueshmëria mediale për KRU- “Hidroregjioni Jugor”, për vitin 2015 ka qenë e kënaqshme dhe e mjaftueshme.

Raporti Gazetar- Zëdhënës ka qenë i lakmueshëm.

Mediat elektronike dhe të shkruara kanë kontribuar edhe në ngritjen e shkallës së arkëtimit në KRU-Hidroregjioni Jugor, duke plasuar informacione të shumta në publik, lidhur me aktivitetin e shkyçjeve të konsumatorëve borxhlinjë.

Të gjithë artikujt e gazetave ditore dhe të gjitha intervistat, emisionet e drejtpërdrejta në televizione dhe radio, janë të ruajtura në arkivën e zyrës për marrëdhënie me publikun.

2.3.1 AKTIVITETET E DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

Departamenti i administrates gjatë këtij tremujori është marrur me përgaditjen e raportëve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

- Gjatë këtij tremujori janë përgaditur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dalura nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, komiteti i financave, komiteti për hulumtime dhe teknologji, komiteti për staf dhe shperblime dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Janë përgaditur dhe vazhduar kontratat e punës për 2015, për të gjithë punëtorët e Kompanisë Kohëzgjatja e kontratave është bërë duke u bazuar ne raportin e vlerësimit vjetor të punës së secilit punonjës.
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lamia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marrëdhënieve të punës.
- Përgaditja e Aktvendimeve për disa punëtor lidhur me kompenzimin e punës jashtë orarit me ditë pushimi sipas Ligjit të Punës.
- Është përgaditur Vendim për mbikqyrje të punimeve në njësinë e Malishevës gjatë implementimit të kontratës” Ndërtimi i galerisë ujëmbledhëse mbi fshatin Senikë -Malishevë, me nr.identifikues të Prokurimit HJ-14-030-521.
- Janë përgaditur dhe shpallur në shtypinë ditorë 4 (katër) konkurse për vendet e parapara të punës nga Menaxhmenti i Kompanisë.
- Për shkelje të detyrave të punës janë shqiptuar masa disiplinore Vërejtje me shkrim për dy punonjës të njësisë së Suharekës.
- Largim të përkohshëm nga puna për katër punonjës të njësisë së Prizrenit. Prej tyre dy inaksant largohen përkohësisht për shkak të mosdorëzimit të mjeteve të inkasuara të konsumatorëve në kompani. Ndërsa nga dy punonjësit roje në objektin ortakoll njeri për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer vepër penale të vrasjes në tentativë nga Neni 178 lidhur me Nenin 28 të KP, veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1. të KP, konform dispozitave të nenit 187 par. 1. Nën paragrafi 1.1. dhe 1.2. në lidhje me p.1.2.1., dhe 1.2.3. të KPP. Punonjësi tjetër roje për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer vepër penale përdorimi i armës apo i mjetit të rrezikshëm nga Neni 375, par. 2. të KP, dhe veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll, ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1. të KP.
- Përgjigjje NJPMNP që nuk kemi pasur kërkesë për qasje në dokumentet publike për periudhen janar-dhjetor 2014 nga asnjë profil i aplikuesve dhe se në të ardhmen nese paraqiten kërkesa të tilla do të trajtohen në përputhje me Ligjin Nr.03/L-215 për qasje në dokumente publike.
- Takim konsultativ-punës në NJPMNP me temë: bashkëpunimi dhe Sfidat e paraqitura në vitin që lamë pas dhe vazhdimi i bashkëpunimit dhe eliminimi i këtyre sfidave në vitin aktual

si dhe komunikimi në mes të NP dhe NJPMNP dhe Arkivimi i dokumentacionit të QK të vitit 2014.

- Pjesmarrja në takimin e organizuar nga Agjencia kundër Korrupsionit, me qëllim të ofrimit të njohurive dhe përgatitjes për procesin e rregullt të deklarimit të pasurisë. Njwherit janë njoftuar me kohë Bordi i Drejtorëve dhe Zyrtarët e Kompanisë se deklarimi i rregullt vjetor fillon nga data 01-31 Mars të çdo viti, për vitin paraparë nga 1 janar deri me 31 dhjetor.
- Mbështetur në Ligjin Nr.04/L-228 për Ndryshimin dhe Plotesimin e Ligjit Nr.04/L-050 për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollimin e Pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik dhe Deklarimin, Prejardhjen dhe kontrollin e Dhuratave për të gjithë Personat Zyrtarë, në Agjensin kundër korrupsionit me kohë është dërguar lista ku janë përfshirë Bordi i Drejtorëve dhe zyrtarët e KRU "Hidroregjioni Jugor" sh.a Prizren për deklarim të rregullt vjetor të pasurisë.
- Është përgaditur Libri lidhës për Qeverisjen Korporative për vitin 2014 dhe dorëzuar në NJPMNP, përmbajtja e saj përfshinë : qertifikatën e regjistrimit të Biznesit, Vendimin mbi emrimin e Bordit, procesverbalet e mbledhjeve të Bordit për 2014, vendimet e Bordit për 2014, procesverbalet e Komisionit të Auditimit, deklarata e politikës së kompenzimit, Vendimet mbi themelimin e komitetëve tjera të Bordit , procesverbalet e komiteteve, plan-biznesi 2014-2016 dhe raporti vjetor 2014.
- Sipas kërkesës së NJPMNP është plotësuar dhe dërguar në Njësi lista e pagave të Zyrtarëve të lartë dhe menaxherëve të tjerë - Kategoria e Parë për Dhjetor 2014.
- Sipas kërkesës së NJPMNP është plotësuar dhe dërguar në Njësi lista me numrin e të punësuarve dhjetor 2014 dhe numrin e të punësuarve të rinjë gjatë vitit 2014.
- Kanë bërë punë praktike profesionale student të Univerzitetit të Prizrenit në fushën e Kontabilitetit dhe financave. Puna praktike profesionale është zhvilluar në mbikqyrje të udhëheqësit nga shërbimit përkatës.
- Është bërë publikimi i tarifave të shërbimit për vitin 2015 në shtypin ditor.
- Nga muaji shkurt janë angazhur me kontratë në kohë të caktuar praktikant në punë praktike ashtu siq është paraparë në Planë Biznes të Kompanisë.
- Në Departament të Administratës kemi patur auditim nga Auditori i Jashtëm "Audit Conto" për vitin 2014.
- Poashtu kemi patur auditim nga Auditori i Brendshëm, Tema e auditimit ka qenë menaxhimi i proceseve dhe aktiviteteve të zhvilluara në departament të administratës, për periudhën kohore gjashtëmujore dhe atë për tremujorin e katërt të vitit 2014 (TM4/2014) dhe tremujorin e parë të vitit 2015 (TM1/2015). Fushëveprimi i auditimit ishin disa nga proceset – aktivitetet, sikurse: procesi i rekrutimit – përzgjedhja e të punësuarëve; procesi i vlerësimit të punës së punonjësve; procesi i shfrytëzimit të pushimeve vjetore, mjekësore dhe pa pagesë, si dhe procesi i komisioneve disiplinore.
- Nga Departamenti administrativ janë dhënë propozime KE për marrjen e masave të nevojshme për tejkalimin apo përmirësimin e situatës së krijuar në Kompani, të cilat propozime janë shqyrtuar dhe përkrahur nga Komiteti për staf.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendëve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Sipas nevojës në nivel rajonal janë vendosur mjetet për mbrojtje kundër zjarrit dhe janë mbajtur trajnime të punëtorëve për mbrojtje kundër zjarrit më pastaj janë paisur me vertetim të kryerjes së tjanimit përkatës.
- Mbështetur në nenin 49 të Ligjit të punës Nr.03/L-212, punonjëses faturiste(R-Sh) në njesinë e Prizrenit I është lejuar pushim me pagesë në emer të pushimit të lehonisë dhe drejta në pushim të lehonisë prej dymbëdhjetë (12) muajve pa nderprerje si dhe mënyra e pagesës së pushimit të lehonisë.
- I është nderprer kontrata e punës një punëtori në njesinë e Prizrenit (S.B) ngase nuk është lajmëruar disa ditë në vendin e tij të punës pas përfundimit të pushimit pa pagesë dhe nuk ka bërë asnjë njoftim për mosardhjen e tij në punë.
- Për shkak të shkeljes së rënd të detyrave të punës janë larguar nga puna tre

punonjës inkasantë të njësisë punuese të Prizrenit(ekzistojnë shkelje të rënda të detyrave të punës të parapara me Nenin 5, pika 1, 2 dhe 3, si dhe Nenin 7, pika 7.1 e Rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të Kompanisë).

- Kanë bërë punë praktike profesionale student të Univerzitetit të Prizrenit në fushën e Kontabilitetit, Menaxhimit të burimeve njerzore, Menaxhimit të Projektëve, në fushën e Informatikës dhe Komunikimit. Puna praktike profesionale është zhvilluar në mbikqyrje të udhëheqësit nga shërbimit përkatës.
- Përgjigjje NJPMNP që nuk kemi pasur kërkesë për qasje në dokumentet publike për periudhen prill-qershor 2015 nga asnjë profil i aplikuesve dhe se në të ardhmen nese paraqiten kërkesa te tilla do te trajtohen në përputhje me Ligjin Nr.03/L-215 për qasje në dokumente publike.
- Sipas kërkesës se NJPMNP janë derguar të dhënat për kompenzimet,honoraret themelore mujore për Bord,Komision te Auditimit,komitetet e tjera dhe bonuset.
- Kemi pranuar Raport Zyrtar nga Inspektorët e punës pas kontrollimit te dokumentacionit dhe administrimit te provave relevante lidhur me rastin e Largimit te përkohëshem nga puna të punonjësit roje Begush Bajrami. Bazuar në gjendjen e konstatuar Inpektorët e Punës kanë konstatuar se nuk ka shkelje te pretenduara nga pala ne kërkesë(BB),për shkak se ndaj palës është ngritur procedura penale në Gjykatën kompetente.
- Mbështetur në Procedura për Mbikqyrje dhe Monitorim e NP Qendrore pika nent(9),është njoftuar me kohë Bordi i Drejtorëve dhe NJPMNP për mungesën e Sekretarit të Kompanisë në punë (pushim vjetor)nga dt.01.09.2015 deri me 31.09.2015.
- Takim pune me Drejtorin e sherbimeve publike,Drejtorin e Inspektoratit dhe Policin rajonale te Prizrenit,me temë të takimit:”Keqpërdorimi I ujit të pijes dhe asistimi I polocisë rajonale të Prizrenit dhe Inspektoratit komunal në parandalimin e keqpërdorimit të ujit të pijes bazuar në ligjet dhe vendimet në fuqi”.
- Janë derguar dokumentet shtesë të kërkuara nga kompania konsulente“ Management Consulting Institute” për të bërë vlerësimin e efektshmërisë së Bordeve në KRU”HRJ”.
- Me Aneks është bërë plotësimi i Marrëveshjes Nr. 719, datë 30.07.2012, ndërmjet K.F. “Liria” me seli në Prizren dhe K.R.U. “Hidroregjionit Jugorë” Sh.A. me seli në Prizren.
- Pjesmarrja në grupin punuesë në SHUKOS për rishikimin dhe ndryshimin e Statutit të SHUKOS-it.
- Gjate muajit korrik 2015 eshte pensionuar nje punetore i Kompanisë pasi që ka mbush moshën e pensionimit prej 65 vjeq sipas kushteve ligjore.
- Gjatë muajit gusht 2015 janë pensionuar dy punonjës të Kompanisë,pasi që kanë mbush moshën e pensionimit prej 65 vjeq sipas kushteve ligjore.
- Gjate muajit shtator 2015 eshte pensionuar nje punetore i Kompanisë pasi që ka mbush moshën e pensionimit prej 65 vjeq sipas kushteve ligjore.
- Janë shqiptuar dy masa disiplinore “vërejtje me goj”për u.d të Udhëheqësit të Njesis së Dragashit dhe Udhëheqësin e sektorit për përpunim të ujit të pijes.
- Përgaditja e dokumenteve të nevojshme për aplikim të vazhdimit të licencës së Kompanisë në ZRRUK.
- Gjithashtu nxënësit e Shkollës së Mesme Administrative kanë mbajtur dhe vazhdojnë të mbajnë orë praktike lidhur me punën e Administratës së Kompanisë.
- Sipas kërkesave të derguara jane marrë dy punëtore me Kontrate per pune dhe detyra specifike
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendëve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Me date 08.10.2015 është pensionuar një (1) punëtorë (HE) Kujdestar- Rojtar në Rezervoari i Shpatit i Njesis Punuese Prizren.

- Me datë 09.10.2015i është ndërprer mardhënja e punes Punetorit Isen Ramanaj - Kontrollor-shkyçje i Njesis Punuese Prizren.
- Gjate muaji Tetor jane shpallur pesë (5) Konkurse.
- Jane bere edhe pune tjera sipas kerkese se U.D Sekretarit te Kompanise.
- Sipas keresave te derguara jane marrë dy punëtore me Kontrate per pune dhe detyra specifike
- Me 01.11.2015 me vetedeshire ka bere shkeputje te kontrates te njeanshme nga një pun onjëse (SGJ) - Zyrtare Ligjore për Marrëdhënie me Konsumatorë.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendëve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Ka pas ngritje te koeficientit per punetorin N.K nga 4 ne 5.
- Punetorja Sahadete Kasolli ka sjell diplomen e bachelore.
- Me date 16.11.2015 jane dhan si kompenzim 300 euro per vdekjen e bashkshortes se punetorit (KK) – Inkasant.
- Ka pas pushime vjetore si kompenzim per punen jashte orarit per per dy punetore.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendëve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Me date 23.11.2015 eshte bere largim i perkoheshem per dy punetore – Rojtar ne objektin Ortakoll – (RB) dhe (MK).
- Punetori (RB) me datë 17.12.2015 është kthyer në punë pas Konstatimit të Komisionit Disiplinorë të Kompanisë se (RB) nuk ka bërë shkelje të detyrve të punës, andaj i njëjti vazhdon punen si punetor i rregullt.
- Punëtori (MK) ende nuk është kthyer në marrëdhënie pune pasi që jemi në pritje të hetimeve nga Krimet e Rënda dhe Prokuroria e Shtetit.
- Me 11.11.2015 i nderpritet kontrata për punë specifike punëtorit të Njesisë së Malishevës (MM) me pozitë të punës Inkasant.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendëve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- Sipas keresave te derguara jane marrë tre punëtor me Kontrate per pune dhe detyra specifike.
- Gjate muajit Dhjetorë janë shpallur tre (3) Konkurse.
- Me kerkesen e Kryshefit Ekzekutiv drejtuar Menaxherëve te Sektoreve që gjatë Djetorit të dorëzohen vlerësimet e bëra të punëtorëve, kemi filluar me kontratat e punëtorëve për vitin 2016.
- Përgaditja e dokumenteve të nevojshme për aplikim të vazhdimit të licencës së Kompanisë në ZRRUK.

2.3.2 Personeli – Janar-Dhjetor 2015

PERSONELI ,BORDI DHE NJESITË PUNUESE JANAR-DHJETOR-2014

| Nr. | Muaji | Hidroregjioni Jugor | Prizren | | | Suharekë | Dragash | Malishevë |
|-----|---------|---------------------|---------|-------|-------|----------|---------|-----------|
| | | | Prizren | Bordi | Total | | | |
| 1 | Janar | 297 | 212 | 5 | 217 | 34 | 18 | 28 |
| 2 | Shkurt | 301 | 213 | 5 | 218 | 35 | 19 | 29 |
| 3 | Mars | 307 | 214 | 5 | 219 | 38 | 21 | 29 |
| 4 | Prill | 308 | 215 | 5 | 220 | 38 | 21 | 29 |
| 5 | Maj | 307 | 216 | 5 | 221 | 37 | 21 | 28 |
| 6 | Qershor | 309 | 219 | 5 | 224 | 37 | 20 | 28 |
| 7 | Korrik | 307 | 218 | 5 | 223 | 36 | 20 | 28 |
| 8 | Gusht | 305 | 218 | 5 | 223 | 34 | 20 | 28 |
| 9 | Shtator | 305 | 216 | 5 | 221 | 35 | 20 | 29 |
| 10 | Tetor | 304 | 216 | 5 | 221 | 34 | 20 | 29 |
| 11 | Nëntor | 305 | 216 | 5 | 221 | 34 | 20 | 30 |
| 12 | Dhjetor | 309 | 219 | 5 | 224 | 34 | 20 | 31 |

2015

| Nr. | Muaji | Hidroregjioni Jugor | Prizren | | | | Suharekë | | Dragash | Malishevë |
|-----|---------|---------------------|---------|-------|--------|-------|----------|--------|---------|-----------|
| | | | Prizren | Bordi | Prakt. | Total | Njesia | Prakt. | | |
| 1 | Janar | 309 | 219 | 5 | | 224 | 34 | | 20 | 31 |
| 2 | Shkurt | 317 | 220 | 5 | 4 | 229 | 36 | | 20 | 32 |
| 3 | Mars | 317 | 220 | 5 | 4 | 229 | 36 | | 20 | 32 |
| 4 | Prill | 315 | 219 | 5 | 4 | 228 | 36 | | 20 | 31 |
| 5 | Maj | 313 | 217 | 5 | 5 | 227 | 36 | | 19 | 31 |
| 6 | Qershor | 313 | 216 | 5 | 5 | 226 | 36 | | 20 | 31 |
| 7 | Korrik | 309 | 215 | 5 | 5 | 225 | 34 | | 19 | 31 |
| 8 | Gusht | 312 | 217 | 5 | 4 | 226 | 34 | 1 | 20 | 31 |
| 9 | Shtator | 312 | 215 | 5 | 5 | 225 | 36 | 1 | 20 | 31 |
| 10 | Tetor | 313 | 216 | 5 | 5 | 226 | 36 | 1 | 19 | 32 |
| 11 | Nentor | 311 | 216 | 6 | 2 | 224 | 36 | | 19 | 32 |
| 12 | Dhjetor | 312 | 218 | 6 | 1 | 225 | 36 | | 19 | 32 |

2.3.3 NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: DHJETOR – 2015

| K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A | | | | | |
|----------------------------------|---------------|-----------------------|----------------------------|--------------|-------------------------------|
| Nacionaliteti | Shqiptarë | Boshnjak dhe Musliman | Romë, Ashkali dhe Egjiptas | Turq | Gjithsejtë numri i punëtorëve |
| Numri i Punëtorëve | 254 | 35 | 5 | 11 | 305 |
| Numri i Punëtorëve në % | 83.3 % | 11.5 % | 1.6 % | 3.6 % | 100 % |

NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

| GJINIA: | NR | NR. % | Nr. Në 1000 Kon. |
|----------|------------|----------------|------------------|
| FEMRA: | 34 | 11.15 % | |
| MESHKUJ: | 271 | 88.85 % | |
| TOTAL | 305 | 100 % | |

2.3.4 KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: DHJETOR 2015

| K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A | | | | | | | | |
|----------------------------------|----------|----------|---------------|-------------|--------|-----------------|---------------|--------------|
| KUALIFIKIMI | | | | | | | | |
| Kualifikimi | Fakultet | Bachelor | Sk.K. e lartë | Sh. e mesme | Sh.N.E | Shkolla fillore | Pa kualifikim | Gjithsejtë |
| Nr. i punëtorëve | 31 | 28 | 0 | 192 | 1 | 48 | 5 | 305 |
| Kualifikimi në % | 10.16 % | 9.18 % | 0.00 % | 62.95 % | 0.33 % | 15.74 % | 1.64 % | 100 % |

2.3.5 PROCEDIMI I LËNDEVE NË GJYKATA

| Periudha raportuese | Padi | Përgjigje në padi | Propozim për Ekzekutim | Kallëzime Penale | Seancat përgatitore | Seancat kryesore | Seancat e shtyra | Deklarata në Prokurori | Parashtrës në Gjykata | Parashtrës në Prokurori | ANKESA në Gjykatën e Apelit të parashtruar nga | ANKESA në Gjykatën e Apelit të parashtruar nga | Përgjigje në Ankesat e Parashtrë në Gjykatën e Apelit nga Konsumatorët | Kundërshtimet nga | TOTALI | Totali i lëndëve të ardhura nga Gjykatat |
|---------------------|----------|-------------------|------------------------|------------------|---------------------|------------------|------------------|------------------------|-----------------------|-------------------------|--|--|--|-------------------|-----------|--|
| JANAR 2015 | / | / | / | / | / | 1 | / | / | / | / | / | / | / | 2 | 3 | 5 |
| SHKURT 2015 | 2 | 2 | / | / | 1 | 1 | 1 | / | / | / | / | / | / | 1 | 8 | 10 |
| MARS 2015 | / | / | / | / | / | / | 2 | / | / | / | / | / | / | / | 2 | 13 |
| PRILL 2015 | / | / | 5 | / | / | 4 | 2 | / | 4 | / | / | / | / | 3 | 18 | 10 |
| MAJ 2015 | / | / | / | / | / | 4 | / | / | 3 | 1 | / | / | / | / | 8 | 6 |
| QERSHOR 2015 | / | / | / | 2 | / | 3 | 1 | 1 | 6 | / | 1 | 1 | 1 | / | 16 | 11 |
| KORRIK 2015 | / | / | / | 8 | 2 | / | / | / | / | / | 1 | / | / | / | 11 | 4 |
| GUSHT 2015 | 1 | 1 | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | / | 2 | 4 |
| SHTATOR 2015 | / | / | / | 1 | 2 | / | 2 | / | / | / | 1 | / | / | / | 6 | 7 |
| TETOR 2015 | 1 | 1 | / | / | 1 | 2 | / | / | 3 | / | / | / | / | / | 5 | 80 |
| NËNTOR 2015 | / | / | / | / | 4 | 2 | 1 | / | / | / | / | / | / | / | 7 | 2 |
| DHJETOR 2015 | / | / | / | / | 3 | 1 | / | / | 2 | / | / | / | / | / | 4 | 12 |
| Totali | 4 | 4 | 5 | 11 | 13 | 18 | 9 | 1 | 20 | 1 | 3 | 1 | 1 | 6 | 95 | 164 |

Janë bërë 8 (tetë) Kallëzime Penale ndaj Konsumatorëve për Kyqje Ilegale në rrjetin e Ujsjellësit të Kompanisë.

Në Prokurorinë Themelore në prizren janë bërë 2 (dy) Kallëzime Penale ndaj ish punëtorëve të Kompanisë.

Gjithashtu në këtë Prokurori janë paraqitur edhe 2 (dy) Njoftime lidhur me 2 (dy) punëtorë të Kompanisë.

Nga Gjykatat janë marrë 30 (tridhjetë) Vendime në favor të Kompanisë sonë.

Te Përmbartuesi Privat i kemi dorëzuar 5 (pesë) Propozime për Përmbartim:

Nga Konsumatorët janë parashtruar 6 (gjashtë) Prapsime.

Janë dhënë 6 (gjashtë) Përgjigje në Prapësimet e Konsumatorëve.

Kundër Kompanisë sonë Gjykatat i kanë marrë 85 (tetëdhjetë e pesë) Vendime.

Prokuroria Themelore e Prizrenit e ka parashtruar një Kërkesë me të cilën ka kërkuar sqarime se a janë respektuar procedurat kur është marrë Vendimi lidhur me 1 (një) punëtorë (GD).

Gjithashtu nga kjo Prokurori e kemi pasur 1 (një) Ftesë për të dhënë deklaratë lidhur me 1 (një) punëtorë(GD).

Nga Kompania janë nxjerrë 11 (njëmbëdhjetë) Vendime.

Nga Gjykata Themelore kanë ardhur 2 (dy) Vërejtje për pagesën e Taksës gjyqësore.

Si pasojë e vdekjes së 1 (një) Konsumatori Gjykata ka marrë Vendim sipas të cilit kjo çështje ndërpritet.

2.3.6 RAPORT I ZYRËS PËR MBROJTJE DHE SIGURI NË PUNË

Nga Zyra për mbrojtje dhe siguri në punë gjatë tremujorit të parë 2015 janë kryer:

- Janë përgatitur dhe shkruar Kontrata dhe Marrëveshje me Firmën “EFEKTI” lidhur me trajnimin e punonjësve për shuarjen e zjarrit;
 - Janë vizituar objektet në Njësinë Punuese të Prizrenit ku janë identifikuar problemet ekzistuese;
 - Është bërë servisimi, ndërrimi si dhe blerja e Aparateve të reja të cilët kanë qenë në mungesë në Kompani dhe janë vendosur në të gjitha Njësitë Punuese të Kompanisë atje ku kanë qenë të nevojshme këto aparate për fikjen e zjarrit;
- Nga Zyra për mbrojtje dhe siguri në punë gjatë tremujorit të tretë 2015 janë kryer dhe përfunduar këto punë:
- Është përfunduar Servisimi dhe blerja e aparateve të reja kundër zjarrit për nevojat e Kompanisë;
 - Është kryer trajnimi i punëtorëve për përdorimin dhe mbrojtjen nga zjarri në nivel të kompanisë;
 - Janë kryer edhe të gjitha punët nga vërejtjet e dhëna nga ana e Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë – Sektori i parandalimit nga zjarri, fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera e Komunës së Prizrenit, përveç atestit të matjes së rrjetit të rrufepritësit dhe përtokëzimit, punë kjo e cila mbetet të përfundohet në periudhën kohore më të shkurtër me angazhimin e personave të autorizuar të kësaj lëmie.
 - Është bërë kontrollimi i skadimit të afatit të Aparateve kundër zjarrit dhe është kryer Servisimi i të njëjtëve për nevojat e Kompanisë;
 - Janë përpiluar dy **(2) forma** të Procesverbaleve për përdorim të Rojtarëve në rast nevoje për vërejtjet gjatë pranimit – dorëzimit të detyrës si dhe Procesverbali për Defektet eventuale në Objekt;
 - Janë kryer edhe të gjitha punët nga vërejtjet e dhëna nga ana e Drejtorisë së Emergjencës dhe Sigurisë;
 - Ende nuk është kryer atesti i matjes së rrjetit të rrufepritësit dhe përtokëzimit, punë kjo e cila mbetet të përfundohet në periudhën kohore më të shkurtër me angazhimin e personave të autorizuar të kësaj lëmie.

2.4.1 AKTIVITETET NGA SHËRBIMI FINANCIAR

KOMENTET FINANCIARE

Gjatë vitit 2015, shërbimi financiar ka pasur aktivitete dhe angazhime të shumta, në arritjen e përfomancave të kompanisë. Më poshtë do t'i cekim ndër më kryesoret:

- Raportet e rregullta ditore nga shërbimi i arkës, gjendjen e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisrisë, bizneseve, gjendjen e llogarive bankare, regjistrimi i tyre.
- Gjithashtu, kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, ku shikohet se a janë të nevojshme blerjet, janë apo jo me kontratë, etj.
- Prgatitja e raporteve mujore-tremujore-gjashtëmujore të përfomancave të kompanisë rreth faturimit, inkasimit dhe shpenzimeve; si dhe raportimet e rregullta në ZRRUK, etj,
- Takimet e rregullta, në lidhje me përfomancën e kompanisë, si me menaxhmentin e kompanisë si dhe anëtarët e bordit.
- Raportimet tre mujore dhe vjetore në MZHE për subvencionet e ndara, për investimet kapitale që kemi bërë të bëra nga mjetet e tyre.
- Të gjitha investimet, si ato nga subvencionet dhe ato vetanake, janë bërë regjistrimet e investimeve në mënyrë të vazhdueshme, nga zyrtari i regjistrimit të aseteve me një përgjegjësi të plotë.
- Githashtu edhe në këtë fund vit, sipas detyrimeve ligjore, janë përcaktuar komisionet për regjistrimin dhe barazimin e arkave, inventarit dhe stokeve në depo, komisione të cilat kanë filluar regjistrimet përkatëse.
- Kemi pasur angazhime të shumta për një inkasim sa më të mirë, ku kemi pasur rritje të inkasimit në vlerë monetare, por si përqindje është një ulje e vogël, kjo mund të ketë ndikuar edhe nga ligji për faljen e borxheve, i cili vonë ka nisur të zbatohet.

Arsyeshmeria e shpenzimeve

- Shpenzimet operative vjetore të ndërmarrjes për vitin 2015, kanë qenë më të larta në krahasim me ato të 2014. Kjo do të thotë se aktivitetet e ndërmarrjes kanë qenë më të mëdha, në mirëmbajtje të rrjetit, në angazhimin më të madhë të pompave të ujit, etj. Më poshtë do të japim arsyetimet në disa nga pozicionet.
- Pozicionet kryesore të shpenzimeve ku mund të kenë pasur rritje apo zvoglim të shpenzimeve, atëherë te pozicioni i pagave kemi një rritje, në krahasim me vitin e kaluar. Më lartë e cekëm, që kompania ka shtuar aktivitetin e saj, dhe me këtë ka qenë e nevojshme edhe shtimi i stafit të saj, në mënyrë që shërbimet tona t'i kënaqin nevojat e konsumatorëve, si atyre aktual dhe konsumatorëve potencial.
- Pozicioni tjetër i cili ka ndikuar në rritje të shpenzimeve operative, është ai i energjisë elektrike. Gjithashtu edhe viti 2015 ka qenë vit që kanë vazhduar investimet, ku furnizimi me ujë ka qenë dukshëm më i mirë nga viti paraprak dhe kjo direkt ka ndikuar edhe në rritjen e kapaciteteve për shtim të pompave, dhe me këtë rast kemi edhe shpenzim më të madh të

energjisë elektrike. Pra gjendja me furnizim me ujë është shumë më e mirë në krahasim me vitet e kaluara.

- Edhe te shpenzimet e derivative kemi rritje të shpenzimeve, por jo në atë masë të madhe që do të ndikonte në shpenzimet totale. Edhe këtu ka qenë nevoja më e madhë në angazhim të makinerisë, pra në intervenime në rrjet, në kontroll e aktivitete tjera rutinore.
- Edhe te shpenzimet tjera operative, ku përfshihen shpenzimet administrative, shpenzimet e telefonise, kemi rritje të tyre, ngase në këtë vit kemi filluar me dizajn të ri të faturave për konsumator, që normal kanë qenë më një kosto më të lartë, por më të përdorshme për konsumatorët. Pra kjo është një nga arsyet për rritje të këtyre shpenzimeve.
- Pra, parë në përgjithësi, shpenzimet operative për 2015 kanë qenë më të larta, dhe kjo ka ndikuar edhe në normë më të ulët të mbulueshmërisë operative, në krahasim me vitin e kaluar.

NJËSIA SUHAREKË

Siç shihet nga Raporti i performancës operative dhe financiare për vitin 2015, Njësia operative në Suharekë, ka koeficientin e mbulimit operativ 0.87 me një mbulueshmëri operative negative prej (45.336,16 €), megjithatë për dallim nga viti 2014 kemi një përmirësim për vlerën prej 21.644,78 €.

Në këtë performancë negative kanë ndikuar:

- Shpenzimet e rrymës elektrike.
- Mos plotësimi i limitit nga Inkasantët
- Mos pagesa e borgjeve nga Institucionet

Shpenzimet e përgjithëshme gjatë vitit 2015 kanë shënuar rënie për vlerën prej 10.896,05 [€] ose 0,38 [%]. Rënia e shpenzimeve gjatë vitit 2015 është si rezultat i kursimeve në shpenzime të derivative të naftës, të rrymës elektrike dhe në disa pozicione më pak të rëndësishme.

Energjia elektrike është një nga pozicionet që shkakton shpenzime të konsiderueshme si pasojë e angazhimit të pompave në stacionet e ndryshme të pompimit edhe pse jemi angazhuar në maksimum që të shfrytëzojmë ujin me rënie të lirë aty ku ka mundësi.

Mbulimi operativ për vitin 2015 ka një ngritje nga 0.81 në vitin 2014, në 0.87 në vitin 2015, ose 7,04 [%] kjo ka ndodhur si rezultat i ngritjes së shkallës së inkasimit dhe zvogëlimit të shpenzimeve.

NJËSIA DRAGASH

Shpenzimeve

Nëse i bëjmë një analizë shpenzimeve vjetore gjatë vitin 2015. duke i krahasuar me periudhën paraprake, kemi ndryshime në disa pozicione, por në përgjithësi si që është edhe në tabelar në vitin 2015 janë më të ulëta për 4.347.94 €.për shkak të shkuarjes së tre puntorve në pension.Shpenzime operative në Njësinë e Dragashit janë minimale dhe nuk kanë shum ndikim në strukturën e shpenzimeve.

Mbulimi operativ.

Në vitin 2015.mbulimi operativ është, nga 1.01 në vitin 2014..në 0.90 në vitin 2015. si shkak i inkasimit jo të mjaftueshëm në këtë periudhë dhe mos realizimi i pagesës së borgjit nga fabrika Remateks në shumën prej 10.000.00 €.

Problemet e hasura gjatë kësaj periudhe:

Inkasimi mbetet obligim kryesor sepse në këtë qështje ka hapsirë për të bërë shumë e më shumë.

Masat e realizuara nga periudha paraprake

Mbështetja e inkasantëve me ekipin e kontrollës në inkasimin e mjeteve është bërë deri në një masë për shkak të angazhimit të kontrollës në vende tjera.

Rritja e presionit ndaj konsumatorëve të cilët nuk i kryejnë obligimet ndaj Kompanisë tonë, përmes paralajmërimeve për shkyçje si dhe shkyçjeve eventuale sipas nevojës.

Koordinimi i veprimeve me organet kompetente komunale në mënyrë që të rritet shkalla e inkasimit në Njësinë punuese në Dragash.

Masat e propozuara për periudhën në vazhdim:

Angazhimi i mëtejshëm i Inkasantëve në plotësimin e limitit.

Mbështetja e Inkasantëve me ekipin e kontrollës në inkasimin e mjeteve.

NJËSIA MALISHEVË

Fakturimi nga uji në €/2015 - kemi ngritje të ujit të fakturuar nga 333.251.19 € në 2014 ,në 336.369.25€ në 2015 pra rritja është për 3.118.06 € ,ose 0.94 %,përshkak të rritjes së numrit të konsumatoreve .

Fakturimet tjera në €/2015 - Jane rritur nga 25.228.85 € në 2014 , në 27.202.99 € në 2015 ,pra rritja është për 1.974.14 €,ose 7.82 % ,përshkak të rritjes së kërkesave për shërbime ,sidomos me Komunen.

Fakturimi total/€ -2015 –është 363.572.24 € ose 5.092.20 € më shumë se në 2014 ,ose 1.42 % .përshkak se fakturimet tjera kanë qenë më shumë për arsye të cekura më lartë.

Inkasimi nga uji në €/2015 –kemi rritje të inkasimit për 26.853.57 € ,krahasuar me 2014 ,ose 12.91 %.

Inkasimet tjera në €/2015 –Ketu kemi rritje të ketyre të hyrave për 5.437.49 € ose 23.68%, përshkak të rritjes së kërkesave nga komuna për shërbime ,por edhe pse ata na kanë mbi 5.000 € borgje nuk na kanë pagu për shërbimet e realizuara nga ne.

Inkasimi Total €/2015-është rritur nga 230.992.86 € në 2014, në 252.408.94 € në 2015 . Pra kemi një rritje prej 21.416.08€ ose 9.27 %.

Shkalla e inkasimit në % është rritur nga 62.42 % -2014, në 69.83 % -2015 ose 11.86 % ,Kjo rritje e normës së inkasimit ka ndodhur përshkak se shumica e inkasanteve e kanë realizuar normën e inkasimit .

Arsyeshmëria e shpenzimeve/2015

Shpenzimet e përgjithshme në €/2015- kanë qenë : 286.047.90 € , pra më shumë për 19.551.60 € ,ose 7.34 % më shumë se në 2014. Tani më poshtë do të paraqesim veq e veq secilin shpenzim të bërë si dhe arsyet e rritjes apo të uljes së tyre.

Shpenzimet ne Energji elektrike /€ /2015 –Jane rritur per 11.11 % . ose 10.860.20 €, me shume se ne vitin 2014 .Rritja e shpenzimeve te energjise elektrike /2015, eshte si rezultat i rritjes se numrit te konsumatoreve per 349 shtimit te dy pompave ne fshatin shkoze 2x15kw =30kw. pasi ky fshat eshte marre ne menaxhim ne fund te vitit 2014.

Gjithashtu ne rritjen e shpenzimeve te energjise elektrike ka ndikuar edhe leshimi i ujit ne fshatin Drenoc i cili fshat me uje furnizohet nga stacioni pompues ne Baje.

Shpenzimet ne Paga /€ 2015 – Jane 147.662.56 € , ne 2014 kane qene 133.315.65 € pra jane rritur per 14.346.91 € ose 10.76 % .Kjo rritje e shpenzimeve ne paga ka ardhë si rezultat i shtimit te tre punetoreve te rinje.

Shpenzimet ne Derivate /€-2015 –jane ulur per 2.594.51 € ose 23.25% me pak se ne vitin 2014. Pra ato ne 2014 kane qene 11.157.71 € tani ne 2015 jane 8.563.20€. Ulja e ketyre shpenzimeve eshte si rezultat i racionalizimit te qarkullimit te automjeteve .

Shpenzimet ne mirembajtje dhe riparime €/ 2015- jane zvoglu per 71.30% .Ne 2014 ato kane qene 11.157.71 € ,tani ne 2014 ato jane ulur ne 8.563.20 € ,ose 10.914.39€ me pak . Ulja e ketyre shpenzimeve eshte per shkak se gjate vitit 2014 jane realizu me shume investime vetanake ne Njesine e Malisheves ne zgjerimin e rrjeteve te ujesjellesit neper disa lagje ne Malisheve e Baje.si dhe pershkak te kursimeve nga ekipet e operatives dhe te mirembajtjes. ,edhe pse numerikisht kemi pasur me shume defekte ne rrjet .

Shpenzimet e mirembajtjes se automjeteve €/2015 - Keto shpenzime kane qene relativisht te njejta me nje rritje per 94.39 € ose 2.47 % . Ne 2014 keto shpenzime kane qene 3.715.93 € ,tani ne 2015 ato jane 3.810.32 €. Edhe pse kemi nje makineri te vjetruar prap se prap mund te themi se perdoruesit e makinave jane treguar shume te kujdesshem ne ngasjen e tyre dhe nuk kane krijuar defekte .

Shpenzimet ne kemikale /2015/€ -Jane rritur nga 206.90 € sa kane qene ne 2014 ,tani ne 2015 ato jane 2.270.61€ per shkak te bartjes se faturave te vitit 2014 ne vitin 2015.


Shpenzimet Tjera /€/2015 -Ne 2014 keto shpenzime kane qene 4.993.08 € ,tani ne vitin 2015 keto shpenzime jane 10.825.64 € ose 5.835.56 € me shume-ose (116.81%) me shume . Kjo rritje e ketyre shpenzimeve ka ndodhur per faktin se jane bere me shume shpenzime ne fatura ,blloka te inkasanteve ,libra te inkasanteve ,çanta etj ,pra pjesa me e madhe jane shpenzime administrative,si rezultat i shtimit te numrit te konsumatoreve.

2.4.1.1 PASQYRË TË PERFORMANCES OPERATIVE DHE FINANCIARE JANAR – DHJETOR 2014- 2015

• NJËSIA PUNUESE - PRIZREN


| MUAJI | JAN-DHJET-2014 | JAN-DHJET-2015 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|-------------------------------|----------------|----------------|---------------|-------------|
| <i>Prodhimi m3</i> | 13,562,010 | 13,641,242 | 79,232 | 0.58 |
| <i>Faturimi m3</i> | 5,557,440 | 5,725,518 | 168,078 | 3.02 |
| <i>Faturimi nga uji €</i> | 3,043,521.65 € | 3,182,161.29 € | 138,639.64 € | 4.56 |
| <i>Faturimi- te tjera €</i> | 66,849.11 € | 56,637.80 € | - 10,211.31 € | -15.28 |
| <i>Faturimi Total €</i> | 3,110,370.76 € | 3,238,799.09 € | 128,428.33 € | 4.13 |
| <i>Inkasimi nga uji €</i> | 2,385,052.62 € | 2,409,788.53 € | 24,735.91 € | 1.04 |
| <i>Inkasimi - te tjera €</i> | 48,418.86 € | 17,196.36 € | - 31,222.50 € | -64.48 |
| <i>Inkasimi Total €</i> | 2,433,471.48 € | 2,426,984.89 € | - 6,486.59 € | -0.27 |
| <i>Nr. i Konsumatorëve</i> | 30,668 | 31,626 | 958 | 3.12 |
| <i>% e inkasimit</i> | 78.36 | 75.73 | -2.64 | -3.36 |
| <i>Shpenzimet</i> | 2,330,349.27 € | 2,486,465.97 € | 156,116.70 € | 6.70 |
| <i>Uji I pafaturuar në m3</i> | 8,004,570 | 7,915,724 | (88,846) | -1.11 |
| <i>Uji I pafaturuar ne %</i> | 59.02 | 58.03 | -0.99 | -1.68 |
| <i>Mbulimi operativ</i> | 1.04 | 0.98 | -0.07 | -6.53 |

103,122.21 € - 59,481.08 € - 162,603.29 €



2.4.1.2 NJËSIA PUNUESE SUHAREKË


| MUAJI | JAN-DHJET-2014 | JAN-DHJET-2015 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|-------------------------------|----------------|----------------|---------------|-------------|
| Prodhimi m3 | 2,137,527 | 1,940,316 | -197,211 | -9.23 |
| Faturimi m3 | 807,304 | 809,090 | 1,786 | 0.22 |
| Faturimi nga uji € | 438,563.52 € | 450,431.48 € | 11,867.96 € | 2.71 |
| Faturimi- te tjera € | 15,549.20 € | 11,510.28 € | - 4,038.92 € | -25.98 |
| Faturimi Total € | 454,112.72 € | 461,941.76 € | 7,829.04 € | 1.72 |
| Inkasimi nga uji € | 271,604.83 € | 285,456.91 € | 13,852.08 € | 5.10 |
| Inkasimi - te tjera € | 15,206.49 € | 12,103.14 € | - 3,103.35 € | -20.41 |
| Inkasimi Total € | 286,811.32 € | 297,560.05 € | 10,748.73 € | 3.75 |
| Nr. i Konsumatorëve | 5195 | 5473 | 278 | 5.35 |
| % e inkasimit | 61.93 | 63.37 | 1.44 | 2.33 |
| Shpenzimet | 353,792.26 € | 342,896.21 € | - 10,896.05 € | -3.08 |
| Uji I pafaturuar në m3 | 1,330,223 | 1,131,226 | (198,997) | -14.96 |
| Uji I pafaturuar ne % | 62.23 | 58.30 | -3.93 | -6.32 |
| Mbulimi operativ | 0.81 | 0.87 | 0.06 | 7.04 |
| | - 66,980.94 € | - 45,336.16 € | 21,644.78 € | |



2.4.1.3 NJËSIA PUNUESE DRAGASH


• NJËSIA PUNUESE - DRAGASH

| MUAJI | JAN-DHJET-2014 | JAN-DHJET-2015 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|-------------------------------|----------------|----------------|---------------|-------------|
| <i>Prodhimi m3</i> | 438,560 | 383,420 | -55,140 | -12.57 |
| <i>Faturimi m3</i> | 218,449 | 190,439 | -28,010 | -12.82 |
| <i>Faturimi nga uji €</i> | 142,796.23 € | 122,356.45 € | - 20,439.78 € | -14.31 |
| <i>Faturimi- te tjera €</i> | 1,763.38 € | 2,576.01 € | 812.63 € | 46.08 |
| <i>Faturimi Total €</i> | 144,559.61 € | 124,932.46 € | - 19,627.15 € | -13.58 |
| <i>Inkasimi nga uji €</i> | 122,754.99 € | 103,880.93 € | - 18,874.06 € | -15.38 |
| <i>Inkasimi - te tjera €</i> | 1,613.30 € | 2,715.33 € | 1,102.03 € | 68.31 |
| <i>Inkasimi Total €</i> | 124,368.29 € | 106,596.26 € | - 17,772.03 € | -14.29 |
| <i>Nr. i Konsumatorëve</i> | 1375 | 1386 | 11 | 0.80 |
| <i>% e inkasimit</i> | 85.97 | 84.90 | -1.06 | -1.24 |
| <i>Shpenzimet</i> | 122,995.42 € | 118,647.48 € | - 4,347.94 € | -3.54 |
| <i>Uji I pafaturuar në m3</i> | 220,111 | 192,981 | (27,130) | -12.33 |
| <i>Uji I pafaturuar ne %</i> | 50.19 | 50.33 | 0.14 | 0.28 |
| <i>Mbulimi operativ</i> | 1.01 | 0.90 | -0.11 | -11.15 |
| | 1,372.87 € | 12,051.22 € | - 13,424.09 € | |



2.4.1.4 NJËSIA PUNUESE MALISHEVË

| MUAJI | JAN-DHJET-2014 | JAN-DHJET-2015 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|-------------------------------|----------------|----------------|--------------|-------------|
| Prodhimi m3 | 1,344,602 | 1,343,711 | -891 | -0.07 |
| Faturimi m3 | 597,616 | 573,413 | -24,203 | -4.05 |
| Faturimi nga uji € | 333,251.19 € | 336,369.25 € | 3,118.06 € | 0.94 |
| Faturimi- te tjera € | 25,228.85 € | 27,202.99 € | 1,974.14 € | 7.82 |
| Faturimi Total € | 358,480.04 € | 363,572.24 € | 5,092.20 € | 1.42 |
| Inkasimi nga uji € | 208,026.43 € | 234,880.00 € | 26,853.57 € | 12.91 |
| Inkasimi - te tjera € | 22,966.43 € | 17,528.94 € | - 5,437.49 € | -23.68 |
| Inkasimi Total € | 230,992.86 € | 252,408.94 € | 21,416.08 € | 9.27 |
| Nr. i Konsumatorëve | 3919 | 4268 | 349 | 8.91 |
| % e inkasimit | 62.42 | 69.83 | 7.40 | 11.86 |
| Shpenzimet | 266,496.30 € | 286,047.90 € | 19,551.60 € | 7.34 |
| Uji I pafaturuar në m3 | 746,986 | 770,298 | 23,312 | 3.12 |
| Uji I pafaturuar ne % | 55.55 | 57.33 | 1.77 | 3.19 |
| Mbulimi operativ | 0.87 | 0.88 | 0.02 | 1.80 |
| | - 35,503.44 € | - 33,638.96 € | 1,864.48 € | |



2.4.1.5 HIDROREGJIONI JUGOR- JANAR-DHJETOR 2015

• HIDROREGJIONI JUGOR - JANAR-DHJETOR- 2014-2015

| MUAJI | JAN-DHJET-2014 | JAN-DHJET-2015 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|-------------------------------|----------------|----------------|---------------|-------------|
| <i>Prodhimi m3</i> | 17,482,699 | 17,308,689 | (174,010) | (1.00) |
| <i>Prodhimi - l/sec</i> | 554 | 549 | (5.5) | (1.00) |
| <i>Faturimi m3</i> | 7,180,809 | 7,298,460 | 117,651 | 1.64 |
| <i>Faturimi l/sec</i> | 228 | 231 | 3.7 | 1.64 |
| <i>Faturimi nga uji €</i> | 3,958,132.59 € | 4,091,318.47 € | 133,185.88 € | 3.36 |
| <i>Faturimi- te tjera €</i> | 109,390.54 € | 97,927.08 € | - 11,463.46 € | (10.48) |
| <i>Faturimi Total €</i> | 4,067,523.13 € | 4,189,245.55 € | 121,722.42 € | 2.99 |
| <i>Inkasimi nga uji €</i> | 2,987,438.87 € | 3,034,006.37 € | 46,567.50 € | 1.56 |
| <i>Inkasimi - te tjera €</i> | 88,205.08 € | 49,543.77 € | - 38,661.31 € | (43.83) |
| <i>Inkasimi Total €</i> | 3,075,643.95 € | 3,083,550.14 € | 7,906.19 € | 0.26 |
| <i>Nr. i Konsumatorëve</i> | 41157 | 42753 | 1596 | 3.88 |
| <i>% e inkasimit</i> | 75.48 | 74.16 | -1.32 | (1.75) |
| <i>Shpenzimet</i> | 3,068,484.22 € | 3,234,057.56 € | 165,573.34 € | 5.40 |
| <i>Paga bruto</i> | 1,728,729.68 € | 1,763,109.72 € | 34,380.04 € | 1.99 |
| <i>Mirmba. dhe riparimet</i> | 260,261.71 € | 239,888.12 € | - 20,373.59 € | (7.83) |
| <i>Rryma elektrike</i> | 798,223.88 € | 909,010.32 € | 110,786.44 € | 13.88 |
| <i>Shpenzi. e derivateve</i> | 97,125.75 € | 85,324.90 € | - 11,800.85 € | (12.15) |
| <i>Kemikalet</i> | 7,030.22 € | 12,538.55 € | 14,113.64 € | 200.76 |
| <i>Shpenzi. tera operat.</i> | 177,112.98 € | 224,185.95 € | 47,072.97 € | 26.58 |
| <i>Uji I pafaturuar në m3</i> | 10,301,890 | 10,010,229 | (291,661) | (2.83) |
| <i>Uji I pafaturuar ne %</i> | 58.93 | 57.83 | -1.09 | (1.85) |
| <i>Uji I pafaturuar l/sec</i> | 326.67 | 317.42 | -9.25 | (2.83) |
| <i>Mbulimi operativ</i> | 1.00 | 0.95 | -0.05 | (4.88) |

7,159.73 € - 150,507.42 € 165,573.34 €

2.4.1.6 PROGRESI NË PLANIN E BIZNESIT

RAPORT I PERFORMANCËS OPERATIVE DHE FINANCIARE CAQET -JANAR - DHJETOR 2015

• HIDROREGJIONI JUGOR -CAQET- JANAR-DHJETOR- 2015

| MUAJI | CAQET 2015 | JAN-DHJET-2015 | NDRYSHIMI | NDRYSHIMI % |
|-------------------------------|----------------|----------------|----------------|-------------|
| <i>Prodhimi m3</i> | 16,145,171 | 17,308,689 | 1,163,518 | 7.21 |
| <i>Prodhimi - l/sec</i> | 512 | 549 | 36.9 | 7.21 |
| <i>Faturimi m3</i> | 8,457,904 | 7,298,460 | (1,159,444) | (13.71) |
| <i>Faturimi l/sec</i> | 268 | 231 | (36.8) | (13.71) |
| <i>Faturimi nga uji €</i> | 4,655,091.88 € | 4,091,318.47 € | - 563,773.41 € | (12.11) |
| <i>Faturimi- te tjera €</i> | 138,057.05 € | 97,827.08 € | - 40,229.97 € | (29.14) |
| <i>Faturimi Total €</i> | 4,793,148.93 € | 4,189,145.55 € | - 604,003.38 € | (12.60) |
| <i>Inkasimi nga uji €</i> | 3,460,239.54 € | 3,034,006.37 € | - 426,233.17 € | (12.32) |
| <i>Inkasimi - te tjera €</i> | 116,610.21 € | 49,543.76 € | - 67,066.45 € | (57.51) |
